

# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur  
Viti XX, nr. 6065  
E premtë, 17 korrik 2020  
çmimi 0.40 €

Rifillon dialogu,  
në Bruksel takohen  
Hoti dhe Vuçiçi FAQE 8-9



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

[facebook.com Gazeta "Epoka e re"](#)



## OPINION

FLET PËR "EPOKËN E RE", ALBERT KRASNIQI

## PARTITË POLITIKE PARA INTERESAVE TË QYTETARËVE KANË VËNË ATO PARTIAKE

Analisti Albert Krasniqi ka thënë se publikimi i njoftimit për dorëzim të aktakuzës ndaj Hashim Thaçit dhe Kadri Veseli do të ketë ndikim në raportet në mes të Kosovës dhe Serbisë. Në këtë intervistë dhënë për gazeten "Epoka e re", ai ka thënë se mungesa e presidentit Thaçi në dialogun me Serbinë do të lërë vakum institucional në këtë proces. Krasniqi e ka

kritikuar qeverinë Hoti për mungesë të rezultateve në dy prioritetet kryesore të saj, për menaxhimin e pandemisë dhe për rimëkëmbjen ekonomike. Ai ka treguar se koalicioni qeverisës është duke hasur në vështirësi për sigurimin e kuorumi të nevojshëm në Kuvend. Po ashtu, Krasniqi ka thënë partitë politike para interesave të qytetarëve kanë vënë ato partiake



## NË PARLAMENTIN E MAQEDONISË SË VERIUT, 32 DEPUTETË SHQIPTARË



Sipas të dhënavëve të Komisionit Shtetëror Zgjedhor të Maqedonisë së Veriut, Lidhja Social Demokrate (LSDM), e drejtuar nga Zoran Zaev, ka dalë subjekti i parë politik në zgjedhjet e parakohshme parlamentare në Maqedoni, me dy deputetë më tepër ndaj VMRO-DPMNE-së. LSDM-ja ka fituar 46 vende në parlament,

VMRO-DPMNE-ja 44, BDI-ja 15, Aleanca për Shqiptarët me Alternativën 12, Lëvizja BESA, e cila garoi në koalicion me LSDM, 4 mandate, kurse PDSH-ja një vend në parlamentin prej 120 vendesh. Ky cikël zgjedhor duket të ketë qenë mjaft i suksesshëm për shqiptarët, të cilët nuk kanë pritur një numër kaq të madh të deputetëve

5 369 raste me Covid-19 në Kosovë,  
deri më tani 118 të vdekur



**RENOVA**  
PUTZ  
Makedoni Xhepcisht-Tetovë Curë-Ferizaj Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755 Fax: +389 44 487 200 Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE  
**PRINCESHA** GROUP SH.P.K.  
INFO: 049-111-101, 044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË



## SPORT

DO TË SHQYRTOHET MUNDËSIA  
PËR RIAKTIVIZIMIN  
E TË GJITHA SPORTEVE F. 16

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegjibiznesi.com  
info@kolegjibiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A.  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302.  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

## Italia i mbyllë kufijtë për Kosovën, Serbinë dhe Malin e Zi

Prishtinë, 16 korrik - Italia ka njoftuar të enjten se ka mbyllur kufijtë për Kosovën, Serbinë dhe Malin e Zi si masë përfshirë prej frenimin e përhapjes së koronavirusit. Përmes një postimi në llogarinë e vet në "Twitter", ministri i Shëndetësisë i Italisë, Roberto Speranza, ka thënë se "Serbia, Mali i Zi dhe Kosova janë futur në listën e vendeve në rrezik". "Atyre që kanë qenë atje në 14 ditët e kaluara, u ndalohet hyrja dhe kalimi transit në Itali. Në botë, epidemia është

në fazën më të vështirë. Kujdesi maksimal është i nevojshëm për ta ruajtur përparrimin e bërë deri më tanë", ka shkruar ministri Speranza. Në kulmin e pandemisë së koronavirusit në mars dhe prill, Italia ka qenë epiqendër e infeksionit. Mbi 243 000 njerëz janë infektuar atje, ndërsa rrëth 35 000 kanë vdekur. Numri i të infektuarve ka qenë në rënienë në javët e fundit dhe ekonomia italiane është në rihapje e sipër. Këtë javë edhe

Austria ka ndaluar fluturimet për dëshira nga vendet e Ballkanit Perëndimor, përfshirë Kosovën. Vendet e këtij rajoni kanë parë rritje të madhe të numrit të rasteve me koronavirus, në javët e fundit. Aktualisht në Kosovë janë të konfirmuara 5 369 raste pozitive. Prej tyre, 118 pacientë kanë vdekur dhe 2 545 janë shëruar. Nga vendet e Ballkanit Perëndimor, Serbia është më e goditura, me gati 20 000 raste pozitive dhe 429 viktima.



Dominic Ebenbichler/REUTERS

## Rama i përgjigjet Metës: Koalicionet s'do të ndalohen, listat do të hapen nga Kuvendi me ligj

TIRANË, 16 KORRIK - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka reaguar pas deklaratës së presidentit Ilir Meta, se nuk do t'i njohë ndryshimet kushtetuese që po ndërmerr nga Kuvendi, pasi janë të njëjshme dhe të paligjshme. Shefi i qeverisë thotë se

ndryshe nga sa pretendon presidenti, sistemi nuk ndryshon dhe as koalicionet nuk ndalohen, por do të ketë vetëm hapje të listave. Në publikimin e tij në llogarinë e vet në "Twitter", Rama i shkruan vetëm inicialet e presidentit, duke konfirmuar sërisht ftohjen mes tyre. "IM thotë ndryshimi i sistemit,

heqja e koalacioneve, hapja e listave bëhen vetëm me referendum. Askund nuk bëhet referendum për këto çështje. Ndërsa këtu as sistemi s'do të ndryshojë, as koalicionet s'do të ndalohen, po listat do të hapen nga Kuvendi i Shqipërisë me ligj, me zakon e me karton. Sa për modelin lindor, modeli i koalicionit që kemi s'është as perëndimor, as jugor, as verior, prandaj nuk gjendet askund në Lindje a në Perëndim. Modeli i ri do të jetë gjerman e plotësisht evropian, koalicion tamam, me zë, figura e program, jo kosh karavidhesh pa din as iman!", ka shkruar Rama.



## Tre persona humbin jetën në 24 orët e fundit në Shqipëri nga Covid-19

TIRANË, 16 KORRIK - Tre pacientë të tjerë kanë vdekur nga Covid-19 në Shqipëri, duke e çuar në 104 numrin e përgjithshëm të viktimate. Ministria e Shëndetësisë në Shqipëri ka njoftuar se janë

konfirmuar 99 raste të reja në 24 orët e fundit. Shpërndarja gjeografike e rasteve është si vijon: 40 raste në Tiranë, nga 6 raste në Fier, Kavajë, nga 5 raste Dibër, Mirditë, nga 4 raste

Krujë, Devoll, nga 3 raste Vlorë, Sarandë, Malësi e Madhe, nga 2 raste Durrës, Kurbin, Korçë, Elbasan, Lezhë, Has, Lushnje, Prrenjas, nga 1 rast në Kukës, Berat, Pogradec, Roskovec.



## Edhe tetë të vdekur nga Covid-19 në Maqedoninë e Veriut

SHKUP, 16 KORRIK - Maqedonia e Veriut ka regjistruar tetë viktima të reja nga Covid-19. Sipas Ministrisë së Shëndetësisë, nga dy viktima janë në Shkup dhe Gostivar, ndërsa nga një në Strugë, Prilep, Kërçovë dhe

Prilep. Numri i përgjithshëm i viktimate ka arritur në 401. Numri më i madh i tyre është në Shkup, Strugë, Shtip dhe Kumanovë.

Sa iu përket të infektuarve, nga testimi i 830 mostrave me

Covid-19 kanë rezultuar 94 raste: 49 në Shkup, 13 në Gostivar, 9 në Sveti Nikollë, 6 në Tetovë, 8 në Shtip, nga 2 në Strugë, Kumanovë, Kërçovë dhe 1 në Prilep. Instituti i Shëndetit Publik

ndërkohë ka regjistruar 42 raste të personave të shëruar: 27 në Shkup, 8 në Prilep, ndërsa numrë më i vogël në pesë qytete të tjera.

Deri tanë nga testimi i 81 604 mostrave me Covid-19 janë



infektuar 8 623 persona, prej tyre 4 603 janë shëruar, 3 619 janë ende aktivë dhe 401 kanë vdekur.

# Në Parlamentin e Maqedonisë së Veriut, 32 deputetë shqiptarë

Sipas të dhënave të Komisionit Shtetëror Zgjedhor të Maqedonisë së Veriut, Lidhja Social Demokrate (LSDM), e drejtuar nga Zoran Zaev, ka dalë subjekti i parë politik në zgjedhjet e parakohshme parlamentare në Maqedoni, me dy deputetë më tepër ndaj VMRO-DPMNE-së. LSDM-ja ka fituar 46 vende në parlament, VMRO-DPMNE-ja 44, BDI-ja 15, Aleanca për Shqiptarët me Alternativën 12, Lëvizja BESA, e cila garoi në koalicion me LSDM, 4 mandate, kurse PDSH-ja një vend në parlamentin prej 120 vendesh. Ky cikël zgjedhor duket të ketë qenë mjaft i suksesshëm për shqiptarët, të cilët nuk kanë pritur realisht një numër të këtillë deputetësh.

**EPOKA  
ERE** Faton DËRMAKU

**SHKUP, 16 KORRIK** - Lidhja Social Demokrate (LSDM), e drejtuar nga Zoran Zaev, ka fituar zgjedhjet parlamentare në Maqedoninë e Veriut me dy deputetë më tepër ndaj VMRO-DPMNE.

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve në Maqedoninë e Veriut ka vazhduar numërimin e votave deri pasditen e së enjtes, ndërsa ka bërë me dije për një sulm kibernetik nga jashtë në faqen e internetit dhe në sistemin e përpunimit të të dhënave. Por, prej 96 për qind të materialevë të përpunuara, rezulton se Lidhja Social Demokrate ka fituar 46 vende në parlament, kurse VMRO-DPMNE-ja 44.

Bashkimi Demokratik për Integrim 15, Aleanca për Shqiptarët me Alternativën 12, Lëvizja BESA, e cila garoi në koalicion me LSDM, 4 mandate, dhe Partia Demokratike Shqiptare një vend në parlamentin prej 120 vendesh. Këto nuk janë rezultate përfundimtare dhe mund të jenë objekt i ndryshimeve, por eventualisht një partit i zgjedhjeve kanë shtohet një dë

tjetrës t'i hiqet një mandat deputeti, nëse ato 4 për qind të votave të papërpunuara mund të ndikojnë në ndryshimin e rezultatit.

Ky cikël zgjedhor duket të ketë qenë mjaft i suksesshëm për shqiptarët të cilët nuk kanë pritur realisht një numër të këtillë deputetësh. Në zgjedhjet që kanë zgjatur deri në orën 21:00 të enjten, të drejtën e votës e kanë shfrytëzuar rreth 51 për qind nga 1.8 milion qytetarë me të drejtë vote.

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve në Maqedoninë e Veriut procesin zgjedhor e ka vlerësuar të rregullt dhe demokratik, me disa parregullsi të vogla që, sipas kryetarit të KShZ-së, nuk kanë ndikuar në mbarëvajtjen e procesit zgjedhor.

Kryetari i LSDM-së, Zoran Zaev, shpalli fitoren e partisë së tij duke theksuar se Maqedonia e Veriut tanimë ka të ardhme edhe më të sigurt. "Ne kemi sukses, njerëzit e mi, me një avantazh prej më shumë se tre mandate ndaj VMRO-DPMNE, me mundësinë edhe për një ose dy mandate të tjera. Koalicioni 'Mundemi' është fitues i zgjedhjeve në të cilat u



konfirmua vullneti i njerëzve. Qytetarët dolën dhe votuan për një të ardhme të sigurt, për unitet dhe solidaritet, për atdhetarizëm, për drejtësi, për një ditë më të mirë dhe një të nesërme më të mirë. Ne i thamë qartë jo rezikut", ka deklaruar Zoran Zaev, duke i vlerësuar zgjedhjet paqësore, të pastra, bazuar në standarde evropiane. Sekretari i përgjithshëm i VMRO-DPMNE-së, Igor Janushev, ka thënë se VMRO-ja është e kënaqur me rezultatin, por jo edhe me procesin zgjedhor, për shkak të, siç ka thënë, parregullsive të shumta. Janushev ka thënë se rezultatet tregojnë se populli dëshiron ndryshimin, andaj VMRO-ja do të mbetet në garë për formimin e qeverisë së re. "Me këtë kredibilitet do të hyjmë në garë për sigurimin e shumicës në Kuvend. Beteja ende nuk ka përfunduar", ka deklaruar Janushev.

Kryetari i BDI-së, Ali Ahmeti, ka deklaruar se fitorja e partisë së tij në këtë zgjedhje është fitore e

të gjithë shqiptarëve. "Me këtë fitore të BDI-së kanë fituar shqiptarët dhe nuk ka humbur askush sepse ne u kemi dalë zot vërtet ashtu siç kemi qenë edhe më parë. Jemi fitues absolutë të zgjedhjeve", ka deklaruar Ahmeti.

Kryetari i Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI), Ali Ahmeti, një ditë pas zgjedhjeve parlamentare në Maqedoni, ku partia e tij ka dalë fituese nga kompleksi shqiptar, ka bërë me dije se ka biseduar nëpërmjet telefonit me Menduh Thaçin dhe Bilall Kasamin. Ahmeti, duke falënderuar qytetarët për mbështetjen, ka thënë se shqiptarët do të jenë më të fortë nëse do të bëhen bashkë. "Të nderuar miq, ju faleminderit për mbështetjen tuaj të madhe dhe për zhvillimin e një procesi shembullor zgjedhor gjer në këto çaste. Sot pranova mijëra urata nga të gjitha trojet tonë për të cilat jam shumë mirënjojës. Gjithashtu, sot realizova biseda telefonike me kryetarin e PDSH-së, z. Menduh Thaçi, dhe kryetarin e Lëvizjes Besa, z. Bilall Kasami, ndërsa do të realizojë biseda edhe me kryetarët e partive të tjera shqiptare, z. Gashi, z. Sela dhe z. Memedi, për ta vlerësuar bashkërisht rezultatin zgjedhor dhe për të këmbyer mendime. Bashkë jemi më të fortë", ka shkruar Ahmeti në llogarinë e vet në "Facebook".

Procesi u vëzhguva nga dhjetëra përfaqësues të ODIHR-it, përfshirë edhe diplomatë të ambasadave në Shkup. Shefja e misionit të ODIHR-it në Shkup, Laima Andrikiene, ka thënë të enjten në një konferencë shtypi, se zgjedhjet në përgjithësi u menaxhuan në mënyrë të efektshme në mes të sfidës së

pandemisë me koronavirusin, por se qëndrueshmëria ligjore u rrezikua me rishqyrimet thelbësore të Kodit zgjedhor dhe rregullimet 'ad hoc' gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, "Fushata me tone negative, megjithatë, ishte konkurruese dhe garuesit patën mundësi t'i dërgojnë mesazhet e tyre. Mbulimit nga ana e medias i mungoi vlerësimi kritik mbi platformat kundrejt reklamimit të paguar, duke favorizuar partitë më të mëdha", ka thënë Andrikiene.

Në zgjedhje kanë marrë pjesë 15 parti politike dhe koalacione, ndërsa nga gjashtë njësítë zgjedhore do të zgjidhen nga 20 deputetë apo 120 sa numëron Kuvendi i Maqedonisë së Veriut. Ministria e Punëve të Brendshme angazhoi rreth 6 000 forca policore për ta siguruar mbarëvajtjen e procesit zgjedhor. MPB-ja njoftoi se ka pranuar 11 denoncime për prishje të procesit zgjedhor. Zgjedhjet e së mërkurës ishin zgjedhjet e dhjeta parlamentare në Maqedoninë e Veriut.

Zgjedhjet duhej të mbaheshin më 12 prill, por ato u shtynë për shkak të pandemisë së koronavirut dhe deri në mbajtjen e tyre vendi është drejtuar nga një qeveri teknike, pjesë e së cilës ka qenë edhe opozita maqedonase.

Zgjedhjet e parakohshme në Maqedoninë e Veriut ishin paralajmëruar nga ish-kryeministri Zoran Zaev që në dhjetor të vitit 2019, pasi ky vend arriti ta marrë datën e fillimit të negociatave me Bashkimin Evropian, pavarësisht prej zbatimit të marrëveshjes me Greqinë për ndryshimin e emrit nga Maqedoni në Maqedoni e Veriut.



FLET PËR "EPOKËN E RE", ALBERT KRASNIQI

# PARTITË POLITIKE PARA INTERESAVE TË



Analisti Albert Krasniqi ka thënë se publikimi i njoftimit për dorëzim të aktakuzës ndaj Hashim Thaçit dhe Kadri Veselit do të ketë ndikim në raportet në mes të Kosovës dhe Serbisë. Në këtë intervistë dhënë për gazeten "Epoka e re", ai ka thënë se mungesa e presidentit Thaçi në dialogun me Serbinë do të lërë vakum institucional në këtë proces. Krasniqi e ka kritikuar qeverinë Hoti për mungesë të rezultateve në dy priorititetet kryesore të saj, për menaxhimin e pandemisë dhe për rimëkëmbjen ekonomike. Ai ka treguar se koalicioni qeverisës është duke hasur në vështirësi për sigurimin e kuoromit të nevojshëm në Kuvend. Po ashtu, Krasniqi ka thënë partitë politike para interesave të qytetarëve kanë vënë ato partiakë

**EPOKA  
ERE** Muhamet KOÇI

**PRISHTINË, 16 KORRIK** - Analisti Albert Krasniqi ka deklaruar se mungesa e presidentit të Kosovës, Hashim Thaçit, në dialogun me Serbinë, do të lërë vakum institucional në këtë proces. Ai ka treguar se ky vakum nuk do të jetë vetëm për shifikat peshës së pozitës së tij. Në këtë intervistë dhënë për gazeten "Epoka e re", ai ka thënë publikimi i njoftimit për dorëzim të aktakuzës ndaj Hashim Thaçit dhe Kadri Veselit do të ketë ndikim në raportet në mes të Kosovës dhe Serbisë. "Mungesa e zotëri Thaçit në procesin e

dialogut do të lërë vakum institucional jo vetëm për peshën e pozitës së tij, por edhe për memorien institucionale pasi është personi i vetëm që është në këtë proces që nga fillimi dhe, për më keq, nuk ka pasur transparencë për atë se si janë zhvilluar negociatat dhe cilat kanë qenë çështjet kyç për të cilat palët kanë hasur në vështirësi për të arritur marrëveshje", ka thënë Krasniqi. Ai e ka kritikuar qeverinë Hoti për mungesë të rezultatit për realizimin e dy prioriteteve kryesore të saj: menaxhimin e pandemisë dhe rimëkëmbjen ekonomike. Sipas Krasniqit, gjatë kësaj periudhe qeveria ka pasur prioritet dialogun me Serbinë, duke e lënë anash menaxhimin e pandemisë.

"Qeveria Hoti në momentin që është zgjedhur ka dhënë premtimin që do të ketë dy prioritete: menaxhimin me pandeminë dhe rimëkëmbjen ekonomike. Për një muaj prej se ka marrë mandatin, nuk ka dhënë rezultate në asnjëren prej këtyre dy prioriteteve. Gjatë kësaj periudhe qeveria ka pasur prioritet dialogun me Serbinë, duke e lënë anash menaxhimin e pandemisë. Masat e para u morën vetëm pas një muaji, kur gjendja veçse ishte përkqësuar ndjeshëm", ka thënë Krasniqi. Ai ka treguar se koalicioni qeverisës

është duke hasur në vështirësi në sigurimin e kuoromit të nevojshëm në Kuvend dhe për t'i siguruar votat e nevojshme për të kaluar ligjet që kërkojnë shumicë të thjeshtë. Krasniqi ka vlerësuar se në rrethana të tillë funksionaliteti i qeverisës rrezikohet, duke shtuar se kjo situatë kërkon ose zgjerim të koalicionit, ose shpërndarje të Kuvendit për t'u hapur rrugë zgjedhjeve të jashtëzakonshme.

anketuar kanë deklaruar se Kuvendi duhet ta ketë prioritet aprovin e pakos ekonomike në mbështetje të ekonomisë së vendit gjatë periudhës së pandemisë, kurse 56 % kanë deklaruar se Kuvendi duhet të iniciojë dhe miratojë legjislacionin e nevojshëm për luftimin e pandemisë. Siç mund të shihet prej përgjigjeve të qytetarëve, pritet e tyre janë ekonomia dhe shëndeti. Këto pritejanë të kundërtat me sjelljet e Kuvendit gjatë periudhës së pandemisë. Partitë politike kanë vënë përpëra interesat e tyre elektorale para nevojave të qytetarëve. Ballafaqimi me pandeminë duhet të jetë një luftë e përbashkët, e të gjitha forcave politike dhe secila prej tyre duhet të ofrojë më të mirën prej vetes, pa kalkuluar në përfshire të votave. Në pyetje janë shëndeti publik dhe ekonomia e vendit. Humbja e kësaj lufte do të ketë pasoja afatgjata për vendin. Prandaj partitë politike, deputetët individualisht, duhet të janë shumë më të arsyeshëm dhe të përgjegjishëm para se të ndërmarrin veprime për të bllokuar apo parandaluar iniciativa që i kontribuojnë luftës

**"Epoka e re": Z. Krasniqi, si po e shihni rolin e Kuvendit të Kosovës gjatë pandemisë? Në çdo seancë parlamentare po ka përplasje të ndryshme politike dhe jo debate për problemet e qytetarëve. Ende nuk janë ratifikuar pesë marrëveshjet ndërkombëtare ndërsa, më në fund, është miratuar në parim projektligi për rishikimin e buxhetit?**

**Krasniqi:** Sipas një sondazhi të publikuar nga Instituti Demokratik Kombëtar (NDI), organizatë kjo amerikane që vepron në Kosovë, në pyetjen se cilat duhet të janë prioritetet e Kuvendit të Kosovës, me mundësi të zgjedhjes së dy opsioneve, 63 % e qytetarëve të

# QYTETARËVE KANË VËNË ATO PARTIAKE

tejet të rendësishëm po luan edhe bashkëpunimi i qytetarëve dhe përfillja e rregullave të institucioneve shëndetësore. Ta zëmë, në vendet si Japonia, ku qytetarët kanë treguar kulturë të larë të kujdesit ndaj vetes dhe të tjerëve, duke i mbajtur maskat, ka dhënë rezultate më të mira për parandalimin e shpërndarjes së virusit. Në Kosovë masat nuk po përfillen nga qytetarët dhe kjo, përvèç që tregon për një nivel të ulët të kujdesit për mirëqenien e përgjithshme, është edhe pasojë e mosfunkcionimit të mekanizmave sankzionues për ata që thyejnë rregullat.

Qeveria Hoti në momentin që është zgjedhur ka dhënë premitin se do të ketë dy prioritetë: menaxhimin me pandeminë dhe rimëkëmbjen ekonomike. Që një muaj prej se e ka marrë mandatin nuk ka dhënë rezultate në asnjëren prej këtyre dy prioriteteve. Gjatë kësaj periudhe qeveria ka pasur prioritet dialogun me Serbinë, duke e lënë anash menaxhimin e pandemisë. Masat e para u morën vetëm pas një muaji, kur gjenda veçse ishte përkqësuar ndjeshëm. Për më tepër, këto masa nuk dukan se janë menduar mirë, më shumë janë nga një qasje ad-hoc njoftimi për të cilat u bë vetëm disa orë para se ato të hyjnë në fuqi, duke mos u dhënë mundësi bizneseve apo qytetarëve të prekur që të bëjnë zgjidhje alternative siç ishte, ta zëmë, myllja e kopshteve përfëmijë.

me pandeminë dhe rimëkëmbjes ekonomike. Ky është prej atyre momenteve në histori që kërkon të lihen anash interesat e ngushta personale dhe partiakë.

**"Epoka e re":** Qeveria ka refuzuar ta çojë në Kuvend projektligjin për pandeminë. Pas rritjes së numrit të infektuarve me Covid-19, ekzekutivi ka ndërmarrë disa masa kufizuese, duke e lënë hapur mundësinë e shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme. Cili është vlerësimi juaj për menaxhimin që qeveria Hoti po i bën pandemisë?

**Krasniqi:** Menaxhimi i pandemisë nuk është një çështje e lehtë dhe e thjeshtë për asnjë shtet, pasi është një situatë me të cilën po përballemi përfundimisht. Shumë vende me ekonomi të zhvilluar dhe me kapacitete të mëdha shëndetësore, siç janë ShBA-ja, Mbretëria e Bashkuar, Italia apo Spanja, kanë pasur probleme serioze dhe menaxhim të dobët të pandemisë përkundër resurseve të shumta që i kanë në dispozicion. Përvèç intervenimit nga institucionet shtetërore, rol

**"Epoka e re":** Për çdo votim të rendësishëm në Kuvend, koalicionit qeverisës po i duhen votat e opozitës. Sa mendoni se mund të zgjasë kjo qeveri, apo pritni një zgjerim të këtij koalicioni?

**Krasniqi:** Koalicioni qeverisës është duke hasur në vështirësi edhe në sigurimin e kuorumit të nevojshëm në Kuvend për të mbajtur mbledhje plenare, por edhe për t'i siguruar votat e nevojshme për t'i kaluar ligjet që kërkojnë shumicë të thjeshtë, mos ta përmendim këtu ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare që kërkojnë votat e dy të tretave të gjithë deputetëve. Në rrethana të tilla, funksionaliteti i qeverisë rrezikohet dhe pashmangshëm kërkon ose zgjerim të koalicionit, ose shpërndarje të Kuvendit për t'u hapur rrugë zgjedhjeve të jashtëzakonshme. Përfshirja e PDK-së në koalicion qeverisës është një skenar i mundshëm, por ekziston edhe një mundësi tjeter që PDK-ja të mos përfshihet në qeveri, por ta ketë përkrahjen e partnerëve të koalicionit për ta zgjedhur presidentin nga radhët e veta kurdo që do të ndodhë kjo, si dhe ta luajë rolin e opozitës konstruktive, duke i votuar disa prej ligjeve të rendësishme të qeverisë, siç mund të jetë Ligj për Buxhetin, si dhe duke i dhënë besimin në rast të ngritjes së mocioneve të mosbesimit. Në sistemin parlamentar të Uestminsterit,

kur partitë politike opozitare nuk marrin poste ministrore në qeveri, por që janë mbështetjen për qeverinë në këmbim të shtyrjes përpëra të politikave të caktuara, njihet si b e s i m - d h e - m b e s h t e t j e (confidence-and-supply). Një skenar i tillë do të ishte në interes edhe të qeverisë, pasi do t'i ofronte më shumë stabilitet, por edhe të PDK-së, e cila do ta kishte të drejtën e propozimit të presidentit dhe t'i shëmangt zgjedhjet, sidomos në këtë kohë kur lideri i saj është duke u përballur me akuzën e Gjykata Speciale.

**"Epoka e re":** Qeveria është deklaruar pro vazhdimit të dialogut me Serbinë. Paralelisht me këtë proces është hapur edhe çështja e aktakuzave të para të Speciales. A mund të ketë Gjykata Speciale ndikim në rifillimin e procesit të dialogut Kosovë - Serbi?

**Krasniqi:** Publikimi i njofimit përdorëzim të aktakuzës ndaj z. Thaçi dhe z. Veseli do të ketë ndikim në raportet në mes të Kosovës dhe Serbisë. Ditë më parë u njofua që Serbia ka dorëzuar edhe dëshmi shtesë në Gjykatën Speciale kundër z. Thaçi. Po ashtu, mungesa e zotëri Thaçit në procesin e dialogut do të lërë vakum institucional jo vetëm për peshën e pozitës së tij, por edhe për nga memoria institucionale, pasi është personi i vetëm që është në këtë proces që nga fillimi dhe, përmë keq, nuk ka

pasur transparencë për atë se si janë zhvilluar negociatat dhe cilat kanë qenë çështjet kyçe për të cilat palët kanë hasur në vështirësi për të arritur marrëveshje.

**"Epoka e re":** Së fundi, kemi parë një moskoordinim në mes të ShBA-së dhe të BE-së për procesin e dialogut. Duket sikur këtë vende janë garë për këtë proces. Si duhet të sillet Kosova në raport me këtë rivalitet të ShBA-së dhe të BE-së në këtë proces?

**Krasniqi:** Krahas mungesës së koordinimit ndërmjet ShBA-së dhe BE-së për procesin e dialogut për normalizim të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, duket se ka pasur edhe një lloj të rivalitetit se kush po e merr primatin në këtë proces. Përmë keq, është vërejtur edhe një lloj mosharmonizimi ndërmjet politikave të administratës së presidentit Trump me ato të Departamentit të Shtetit, si përfshirja e ShBA-së, të cilën liderët kosovarë me ngulm e kanë kërkuar, ashtu edhe BE-ja janë shumë të rendësishme përtak mundësuar marrëveshjen dhe garantuar zbatimin e marrëveshjeve të arritura deri më tanë. Kosova nuk duhet të ketë qasje preferenciale ashtu siç ka ndodhur kohën e fundit. Për presidentin Thaçit duket se administrata Trump ka qenë më e preferuar, kurse ish-kryeministri Kurti ka pasur preferenca për BE-në.

## Rifillon dialogu, në Bruksel takohen Hoti dhe Vuçiqi

**BRUSEL, 16 KORRIK (ER) -** Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, është takuar të enjten në Bruksel me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq, pas gati dy vjetësh bllokadë të procesit dialogues. Përfaqësuesit e Kosovës dhe Serbisë u mirëpritën në fillim në takime të ndara, nga kreu i diplomacisë evropiane, Josep Borrell, ndërsa i dërguari i posaçëm i BE-së për dialogun, Miroslav Lajçak, do të marrë pjesë në negociatë.

Hoti në takim me Vuçiqin ishte i shoqëruar nga dy zëvendësitet e tij, Driton Selmanaj, Albulena Balaj-Halimi dhe ministri i Drejtësisë, Selim Selimi.

Përfaqësuesi i Lartë i BE-së për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Josep Borrell, para takimit ka inkurajuar Kosovën dhe Serbinë që të zhvillojnë një dialog në



frymën e kompromisit dhe pragmatizmit. "Pres diskutim konstruktiv që do t'i kon-

tribuonte normalizimin gjithëpërfshirës të raporteve ndërmjet dy vendeve", ka

deklaruar Borrell. Ai ka theksuar se i vjen mirë që BE-ja e ka rikthyer rolin udhëheqës të dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Në fakt, dialogu virtualisht rifilloi më 12 korrik, ku palët biseduan përmes një video- konferencë, por takimi i së enjtes paraqet bisedimet e para të drejtëpërdrejtë pas 20 muajsh.

Ky gjithashtu, është takimi i parë në të cilin nuk do të marrë pjesë ish-bashkëbiseduesi kryesor i Brukselit nga Prishtina - presidenti i Kosovës Hashim Thaçi.

Ky raund i dialogut po zhvillohet në Bruksel, derisa Thaçi po vazhdon të dëshmojë para Prokurorisë Speciale në Hagë, kundër të cilës është dërguar një aktakuzë për shqyrtim për krimet luftë dhe krimet kundër njerëzimit.

# Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, me projekt të ri për mësimin në distancë

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

**FERIZAJ, 16 KORRIK** - Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF) dhe Shkolla Austriake e Studimeve të Aplikuara (ASAS) kanë mbajtur takimin e parë virtual të projektit për mësimin në distancë në arsimin e lartë akademik dhe të vazhdueshëm, zhvillimin e programeve në distancë dhe në prani. Ky projekt është financuar nga Austrian Development Agency (ADA) dhe ASAS, vlera e të cilët është mbi 400 000.00 euro. Në këtë takim u paraqitën objektivat e projektit të mësimit në distancë, rezultatet e pritura dhe plani i zbatimit për dy vjetët e ardhshëm.

Rektori i UShAF, prof. dr. Agron Bajraktari, ka falënderuar të gjithë pjesëmarrësit në takim dhe ka folur për bashkëpunimin shumëvjeçar me shtetin austriak dhe mbështetjen që i ka ofruar gjithmonë ky shtet, në veçanti Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Salzburg. Po ashtu, ai ka thënë se do të realizojnë me shumë përkushtim çdo gjë që



kërkohet në këtë projekt. Ndërsa ambasadori Christoph Weidinger nga Ambasada e Austrisë në Kosovë, veç të tjerash, ka thënë se shteti austriak mbështet UShAF-in dhe programet e tij, të cilat janë të dizajnuara për tregun e punës. Po ashtu, ai ka thënë se

bashkëpunimi me UShAF nuk do të mbarojë me këtë projekt, por do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Ramë Likaj, ka thënë se do të ofrojë mbështetje për realizimin e tij. Besim Mustafa nga Oda

Ekonomike e Kosovës ka theksuar se janë me fat që kanë filluar këtë projekt në kohën e pandemisë dhe se aktivitetet e edukimit janë shumë të rëndësishme për ta. Në kuadër të këtij projekti, UShAF dhe ASAS së bashku do ta lansojnë mësimin në

distancë në Kosovë, duke krijuar trajnime të certifikuar universitare në distancë për studentët dhe profesionistët e punës, të cilat do të ofrohen nga UShAF dhe Universitetet Austriake ose partnerët e tyre implementues.

Pritet që ky projekt ta krijojë shkëmbimin e njohurive në prezantimin e mësimit në distancë, i cili do të kontribuojë në rritjen ose forcimin e punësueshmërisë së studentëve dhe profesionistëve në Kosovë. Po ashtu, studentët do të pajisen me diplomë të përbashkët nga UShAF dhe Universiteti i Grazit.

ASAS është partner i "E-learning group Austria" dhe ka zyrën përfaqësuese në Kosovë. Kjo zyrë do të kontribuojë në ofrimin e arsimit dhe aftësimit akademik modern dhe të përshtatur për studentë dhe profesionistë që punojnë me qëllim kryesor të kontribuojnë në zhvillimin e sektorit privat në Kosovë, duke ofruar programe plotësuese të arsimit dhe trajnimit akademik të cilat kërkojnë nga komuniteti i biznesit dhe që nuk ofrohen aktualisht nga institucionet e arsimit të lartë në Kosovë.

## Kosova dhe Shqipëria koordinohen për harmonizimin e kurrikulave të arsimit parauniversitar



**PRISHTINË, 16 KORRIK (ER)** - Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Ramë Likaj, ka pritur të enjten në takim ministren e Arsimit, Sportit dhe Rinisë të Shqipërisë, Besa Shahini, me të cilën ka biseduar për gjendjen në arsim në të dy vendet. Në takim është biseduar për bashkëpunimin e deritanishëm të Kosovës dhe të Shqipërisë në arsim dhe mundësitet e thellimit të bashkëpunimit me qëllim të ngritjes së cilësisë në të gjitha nivelet e arsimit. Njëherësh, ministrat janë marrë vesh për

harmonizim të mëtejmë të kurrikulave të arsimit parauniversitar, si dhe për shkëmbim të platformave digitale për mësimin online, shumë të nevojshëm në kohën e pandemisë.

Ministri Likaj dhe Shahini biseduan edhe për situatën e pandemisë, e cila ka shkaktuar vështirësi të mëdha në të gjithë sektorët, veçanërisht në arsim. Të dy ministrat e Arsimit u morën vesh që ta shtojnë bashkëpunimin, sidomos përgatitjet që po bëhen në Kosovë dhe Shqipëri për fillimin e vitit të ri shkollor.

## Familjarët ia çojnë kasetofonin me telefona brenda të burgosurit në Dubravë

**PRISHTINË, 16 KORRIK (ER)** - Në Qendrën Korrektuese në Dubravë gjatë kontrollimit të gjërave të sjella nga familjarët e një të burgosuri, oficerët korrekues kanë arritur ta parandalojnë futjen e kontrabandës në këtë qendër. "Oficerët korrekues në vazhdimësi të planit operativ për bastisje të qëllimta kanë bërë bastisjen e një kasetofoni, i cili ishte sjellë nga

familjarët e të burgosurit. Bastisja ka rezultuar pozitive, me ç'rast në brendinë e kasetofonit janë gjetur një telefon mobil 'Samsung' J5, një telefon mobil 'LB STAR' (mini), një bateri e telefonit mobil 'Samsung' dhe tri kabllo të mbushësit për telefonë mobilë", ka njoftuar Shërbimi Korrekues i Kosovës do të vazhdojë ta ketë primare luftimin e dukurive negative dhe kontrabandës", bëhet me dije në njoftimin e ShKK-së.

Lidhur me rastin, i burgosuri



# 5 369 raste me Covid-19 në Kosovë, deri më tani 118 të vdekur

Sipas rezultateve të fundit të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK), janë konfirmuar edhe 132 raste të reja pozitive me Covid-19 dhe gjashtë persona kanë vdekur. IKShPK-ja ka njoftuar se numri total i rasteve pozitive me Covid-19 është 5 369. Institut Kombëtar ka bërë thirrje për respektim të masave kundër Covidit

**EPOKA ERE** Faton DËRMAKU

**PRISHTINË, 16 KORRIK** - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se më 15 korrik janë konfirmuar edhe 132 raste të reja me Covid-19, ndërkaq po me këtë datë kanë vdekur edhe gjashtë persona nga ky virus, duke e çuar numrin e vdekjeve në 118. "Më datën 15 korrik 2020, në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK, me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 486 mostra të marra nga ShSKUK dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 132 raste pozitive. Numri total i rasteve pozitive është 5 369 raste nga 29 546 persona të dyshimitë me virusin SARS-CoV-2, me gjithsej 118 raste të vdekjes të cilët kanë pasur sëmundje të tjera shqëruuese", është bërë me dije më njoftimin e IKShPK-së.

Rastet pozitive janë nga: komuna Prishtinë 47 raste,

komuna Ferizaj 16 raste, komuna Mitrovicë 16 raste, komuna Gjilan 12 raste, komuna Podujevë 6 raste, komuna Vushtrri 5 raste, komuna Viti 4 raste, komuna Drenas 4 raste, komuna Fushë Kosovë 4 raste, komuna Pejë 3 raste, komuna Prizren 3 raste, komuna Deçan 2 raste, komuna Kaçanik 2 raste dhe me nga 1 rast komunat: Kamenicë, Klinë, Graçanicë, Kllokot, Mitrovicë e Veriut, Obiliq, Rahovec dhe Skenderaj. Sipas këtij njoftimi, më 15 korrik janë shëruar edhe 83 patientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 2 545 raste, kurse numri i rasteve aktive është 2 706. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike u ka bërë thirrje qytetarëve që t'i respektojnë masat kundër Covidit. "Zbatimin e rekomandimeve të Institutit Kombëtar dhe Ministrisë së Shëndetësisë duhet ta bëjë çdo qytetar i Republikës së Kosovës, që t'i ruajë veten, t'i afërmít dhe



të tjerët. Apelojmë te qytetarët, bizneset, gastronomia, që në mënyrë strikte ta respektojnë distancën fizike, përdorimin e maskave, dezinfektimin dhe ajrosjen e lokaleve, duke pamundësuar përhapjen eventuale të infeksionit dhe shmangjen e përhapjes në hapësirat e myllura", është thënë më njoftimin e IKShPK-së. Sipas IKShPK-së, çdo shkelje e rregullave nga kushdo do të konsiderohet rrezikim i shëndetit dhe jetës së të tjerëve. Vazhdoni ta mbani distancën fizike dhe maskat. Lani duart me kujdes disa herë në ditë nga 20-30 sekonda. Lehtësimi i masave është bërë për të na bërë më të përgjegjshëm", ka njoftuar IKShPK-ja.

## 104 zyrtarë të MPB-së me Covid-19, katër nga kabineti i Velikut

104 zyrtarë në Ministrinë e Punëve të Brendshme janë të infektuar me Covid-19, katër prej të cilëve janë zyrtarë nga kabineti i ministrit Agim Veliku. Kështu ka thënë përkrahja e klankosova.tv, Roksana Qarri nga MPB, e cila ka shtuar se të gjithë të infektuarit janë në gjendje stabile dhe se janë duke qëndruar të vitezoluar. "Deri më sot në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Agjencitë e MPB-së, gjithsej janë të infektuar 104 zyrtarë me Covid-19, ku nga ta 20 zyrtarë janë nga stafi civil, 4 zyrtarë nga kabineti i ministrit

si dhe 80 janë zyrtarë policorë. Sipas raportimeve, gjendja e tyre është stabile, ku të gjithë të infektuarit janë të vitezoluar në shtëpitë e tyre, në përgjashim të gjashtë zyrtarëve policorë që gjenden në spital për trajtim. MPB-ja është e informuar se gjendja e tyre është stabile përmomentin. Po ashtu, disa zyrtarë të cilët janë raste të kontaktit me personat e infektuar me Covid-19 janë në vitezolim, por pa simptome. Ju njoftojmë që MPB është duke punuar me staf esencial sipas rekomandimeve të IKShPK-së, ka thënë Qarri.

# Ministri Veliu i ofron përkrahje Akademisë së Kosovës për Siguri Publike

**PRISHTINË, 16 KORRIK (ER)** - Ministri i Punëve të Brendshme, Agim Veliku, ka vizituar të enjten Akademinë e Kosovës për Siguri Publike (AKSP), ku është pritur nga drejtori i përgjithshëm i saj, Ismail Smakiqi. Me këtë rast, ministri Veliu është njoftuar përsë afërmimi me punën e AKSP-së dhe sfidat që janë duke i kaluar ata gjatë periudhës së pandemisë Covid-19.

Ministri Veliu në këtë takim ka shprehur gatishmërinë e tij përtë mbështetur këtë institucion që tashmë njihet ndërkombëtarë. Ai, gjithashtu, ka falënderuar partnerët ndërkombëtarë që kanë dhënë kontribut të vazhdueshëm në përkrahjen e këtij institucioni dhe është zotuar për përkrahjen e Akademisë në proceset e akreditimit të cilat e presin në periudhën e ardhshme. Në anën tjetër, Smakiqi ka bërë



një prezantim të shkurtër të AKSP-së, ku e ka njoftuar Veliu që implementimin e programeve dhe trajnimeve të dizajnuara në bazë të standardeve më të larta ndërkombëtare përtë drejtat e njeriut dhe sundimin e ligjit, do

të jenë primare dhe obliguese përtë gjithë, në mënyrë që të arrihet profesionalizëm më i lartë në shërbim të vendit dhe qytetarëve. Gjatë kësaj vizite, ministri Veliu i është prezantuar ushtrimi praktik me instruktor, ku

kadetët e FATS-it patën rastin ta demonstrojnë ushtrimin me armë zjarri, si dhe ka vizituar klasën ku po mbahen trajnimet online me kadetë. Në fund ministri Veliu u është drejtuar kadetëve duke i inkurajuar përdurim dhe

disiplinë gjatë kësaj periudhe të pandemisë si dhe ka kërkuar nga ta të tregojnë angazhim dhe përkushtim përtë arritur rezultate sa më pozitive si në anën profesionale, po ashtu edhe në atë të shkaktësive fizike.

# Në muajin qershor 'Kosova B' ka realizuar planin e prodhimit me 116 për qind

EPOKA  
ERE

Albulena S. MAVRAJ

**PRISHTINË, 16 KORRIK** - Korporata Energetike e Kosovës (KEK) ka njoftuar se, pavarësisht prej situatës së rënduar në gjithë vendin, e krijuar si pasojë e pandemisë Covid-19, me angazhimin maksimal të menaxhmentit dhe punëtorëve TC 'Kosova B', ka arritur që me sukses të jashtëzakonshëm ta përmbyllë muajin qershor me një realizim të planit të prodhimit prej 116 përqindësh. Në këtë drejtim, u. d. i drejtorit ekzekutiv në TC 'Kosova B', Jonuz Saraci, ka thënë se më 31 maj 2020 ka filluar riparimi dyzetditor i Bllokut B1. "Sipas

planit, fillimi i punës së Bllokut B1 ka qenë i paraparë të ndodhë më 11 korrik 2020, mirëpo pas një riorganizimi të mirë të punës dhe pas një angazhimi të shtuar të punëtorëve, përkundër pandemisë dhe problemeve përcjellëse, kemi arritur që riparimin ta përfundojmë për 26 orë më herët sesa që ishte planifikuar", është shprehur ai.

Ai më tutje ka shtuar se, krahas punës në B1, ku shumica e punëtorëve ishin të angazhuar, sfidë tjetër përbente edhe angazhimi në mirëmbajtjen dhe operimin në Bllokun B2. "Kushtet në të cilat punëtorët punonin vërtet ishin të rënduara, për shkaqet e

theksuara më lart, por përkundër saj rezultati dhe suksesi nuk kishte munguar. Në Bllokun B2 për muajin qershor kishim tejkalim të planit për 16 për qind, pra kishim një realizim prej 116 përqindësh të planit të prodhimit. Kjo ishte vërtet një sukses i mirë, sepse ta tejkalosh prodhimin në këto kushte nuk është edhe aq lehtë. Për më tepër, jemi në prite që edhe për muajin korrik të kemi rezultate të mira në prodhim si dhe tejkalim të planit. Deri më tanë nuk kemi ndonjë problem, por shpresojmë se rezultatet do të përmbushen sipas planit. Nuk mundem pa i falenderuar të gjithë punëtorët që ishin angazhuar gjatë kësaj kohe, por



edhe stafin udhëheqës të tyre që nuk kursyen mundin dhe djersën për të arritur rezultatet e lartcekura. Së bashku do të

vazhdojmë drejt sukseseve të tjera", ka dekluarar Jonuz Saraci, ushtrues detyre i drejtorit ekzekutiv në TC 'Kosova B'.

## KRU 'Prishtina' shton kontrolllet, has në shumë kyçje ilegale



**PRISHTINË, 16 KORRIK (ER)** - Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Prishtina" ka njoftuar të gjithë konsumatorët në zonën e shërbimit, Prishtinë, Fushë-Kosovë, Lipjan, Podujevë, Obiliq, Shtime, Drenas dhe Graçanicë, se me komisione të veçanta është duke vazhduar identifikimin dhe kontrollimin e të gjitha zonave të shërbimit, përgjetjen e kyçjeve ilegale në sistemin e rrjetit të ujësjellësit, manipulimeve me ujëmatës

dhe keqpërdorimeve të formave të tjera. Sipas KRU 'Prishtina', vetëm në muajin e fundit janë kontrolluar shumë zona, derisa janë identifikuar një numër i konsiderueshëm i konsumatorëve të cilët kanë manipuluar me ujëmatës. "Sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës - Kodi Nr. 06 / L - 074, Neni 314, konsiderohet vepër penale çfarë manipulimi apo vjedhje që përfshihet edhe shërbimi me ujë. Në kuadër të

reduktimit të humbjeve të ujit, inspektorët po vazhdojnë me veprime konkrete në terren. Në të njëjtën kohë, kërkojmë nga konsumatorët që të realizojnë pagesa për shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, po ashtu mundësia e lehtë për kryerjen e shërbimeve ende vazhdon, si riprogramimi i borxheve të akumuluara për shërbimet (me këste mujore 12-36 muaj) varësisht nga shuma totale e borxhit", thuhet në komunikatën e KRU 'Prishtina'.

## BQK-ja shpall konkursin për çmimin 'Ekonomistët e rinj'

**Prishtinë, 16 korrik (ER)** - Në funksion të nxitjes së hulumtimeve mes ekonomistëve të rinj të Kosovës, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) ka krijuar mundësinë e dhëniec së një çmimi për studimin më të mirë të paraqitur nga ekonomistët e rinj.

Punimet për këtë çmim duhet të

jenë në fushën e sektorit finansiar dhe zhvillimit ekonomik në Kosovë, me theks të veçantë duke iu përshtatur rrëthanave të reja të krijuara gjatë vitit 2020 në vend dhe ekonominë botërore. Duke vlerësuar rëndësinë e rrëthanave të krijuara nga Covid-19, kësaj radhe tema që duhet të shtullohet është

"Ekonomia e Kosovës në kohë pandemie, ndikimet e Covid-19 në ekonominë vendore dhe ndërkombëtare".

Lidhur me këtë, BQK-ja do të organizojë një ngjarje të veçantë për shpalljen e punimeve më të mira të dorëzuara. BQK-ja në uebfaqen e vet ka paraqitur rregullat që duhen ndjekur përkështetjet e madhe që ndër vite Banka Botërore i ka dhënë shtetit tonë dhe tanë që po vazhdon të japë kontributin e saj në funksion të rimëkëmbjes ekonomike pas përhapjes së pandemisë.




## Banka Botërore mbështet ministrin Reçica për reformat e ndërmarrë

**PRISHTINË, 16 KORRIK (ER)** - Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skënder Reçica, të enjten ka zhvilluar një takim virtual me drejtorin e ri të Bankës Botërore për Kosovë, Massimiliano Paolucci, me të cilin ka diskutuar lidhur me situatën e krijuar ekonomike dhe sociale në vendin tonë si pasojë e

pandemisë Covid-19. Reçica e ka njoftuar drejtorin e ri të Bankës Botërore për reformat e ndërmarrë nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, me theks të veçantë reformën pensionale dhe vazhdimin e reformës së asistencës sociale, për të cilat edhe ka marrë përkrahjen e

plotë nga ai.

Gjatë këtij takimi virtual, i pari i MPMS-së e ka falenderuar drejtorin e ri të BB-së për mbështetjen e madhe që ndër vite Banka Botërore i ka dhënë shtetit tonë dhe tanë që po vazhdon të japë kontributin e saj në funksion të rimëkëmbjes ekonomike pas përhapjes së pandemisë.



# Në muajin qershor 'Kosova B' ka realizuar planin e prodhimit me 116 për qind

EPOKA  
ERE

Albulena S. MAVRAJ

**PRISHTINË, 16 KORRIK** - Korporata Energetike e Kosovës (KEK) ka njoftuar se, pavarësisht prej situatës së rënduar në gjithë vendin, e krijuar si pasojë e pandemisë Covid-19, me angazhimin maksimal të menaxhmentit dhe punëtorëve TC 'Kosova B', ka arritur që me sukses të jashtëzakonshëm ta përmbyllë muajin qershor me një realizim të planit të prodhimit prej 116 përqindësh. Në këtë drejtim, u. d. i drejtorit ekzekutiv në TC 'Kosova B', Jonuz Saraci, ka thënë se më 31 maj 2020 ka filluar riparimi dyzetditor i Bllokut B1. "Sipas

planit, fillimi i punës së Bllokut B1 ka qenë i paraparë të ndodhë më 11 korrik 2020, mirëpo pas një riorganizimi të mirë të punës dhe pas një angazhimi të shtuar të punëtorëve, përkundër pandemisë dhe problemeve përcjellëse, kemi arritur që riparimin ta përfundojmë për 26 orë më herët sesa që ishte planifikuar", është shprehur ai.

Ai më tutje ka shtuar se, krahas punës në B1, ku shumica e punëtorëve ishin të angazhuar, sfidë tjetër përbente edhe angazhimi në mirëmbajtjen dhe operimin në Bllokun B2. "Kushtet në të cilat punëtorët punonin vërtet ishin të rënduara, për shkaqet e

theksuara më lart, por përkundër saj rezultati dhe suksesi nuk kishte munguar. Në Bllokun B2 për muajin qershor kishim tejkalim të planit për 16 për qind, pra kishim një realizim prej 116 përqindësh të planit të prodhimit. Kjo ishte vërtet një sukses i mirë, sepse ta tejkalosh prodhimin në këto kushte nuk është edhe aq lehtë. Për më tepër, jemi në prite që edhe për muajin korrik të kemi rezultate të mira në prodhim si dhe tejkalim të planit. Deri më tanë nuk kemi ndonjë problem, por shpresojmë se rezultatet do të përmbushen sipas planit. Nuk mundem pa i falenderuar të gjithë punëtorët që ishin angazhuar gjatë kësaj kohe, por



edhe stafin udhëheqës të tyre që nuk kursyen mundin dhe djersën për të arritur rezultatet e lartcekura. Së bashku do të

vazhdojmë drejt sukseseve të tjera", ka dekluarar Jonuz Saraci, ushtrues detyre i drejtorit ekzekutiv në TC 'Kosova B'.

## KRU 'Prishtina' shton kontrolllet, has në shumë kyçje ilegale



**PRISHTINË, 16 KORRIK (ER)** - Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Prishtina" ka njoftuar të gjithë konsumatorët në zonën e shërbimit, Prishtinë, Fushë-Kosovë, Lipjan, Podujevë, Obiliq, Shtime, Drenas dhe Graçanicë, se me komisione të veçanta është duke vazhduar identifikimin dhe kontrollimin e të gjitha zonave të shërbimit, përgjetjen e kyçjeve ilegale në sistemin e rrjetit të ujësjellësit, manipulimeve me ujëmatës

dhe keqpërdorimeve të formave të tjera. Sipas KRU 'Prishtina', vetëm në muajin e fundit janë kontrolluar shumë zona, derisa janë identifikuar një numër i konsiderueshëm i konsumatorëve të cilët kanë manipuluar me ujëmatës. "Sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës - Kodi Nr. 06 / L - 074, Neni 314, konsiderohet vepër penale çfarë manipulimi apo vjedhje që përfshihet edhe shërbimi me ujë. Në kuadër të

reduktimit të humbjeve të ujit, inspektorët po vazhdojnë me veprime konkrete në terren. Në të njëjtën kohë, kërkojmë nga konsumatorët që të realizojnë pagesa për shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, po ashtu mundësia e lehtë për kryerjen e shërbimeve ende vazhdon, si riprogramimi i borxheve të akumuluara për shërbimet (me këste mujore 12-36 muaj) varësisht nga shuma totale e borxhit", thuhet në komunikatën e KRU 'Prishtina'.

## BQK-ja shpall konkursin për çmimin 'Ekonomistët e rinj'

**Prishtinë, 16 korrik (ER)** - Në funksion të nxitjes së hulumtimeve mes ekonomistëve të rinj të Kosovës, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) ka krijuar mundësinë e dhëniec së një çmimi për studimin më të mirë të paraqitur nga ekonomistët e rinj.

Punimet për këtë çmim duhet të

jenë në fushën e sektorit finansiar dhe zhvillimit ekonomik në Kosovë, me theks të veçantë duke iu përshtatur rrëthanave të reja të krijuara gjatë vitit 2020 në vend dhe ekonominë botërore. Duke vlerësuar rëndësinë e rrëthanave të krijuara nga Covid-19, kësaj radhe tema që duhet të shtullohet është

"Ekonomia e Kosovës në kohë pandemie, ndikimet e Covid-19 në ekonominë vendore dhe ndërkombëtare".

Lidhur me këtë, BQK-ja do të organizojë një ngjarje të veçantë për shpalljen e punimeve më të mira të dorëzuara. BQK-ja në uebfaqen e vet ka paraqitur rregullat që duhen ndjekur përkështetjet e madhe që ndër vite Banka Botërore i ka dhënë shtetit tonë dhe tanë që po vazhdon të japë kontributin e saj në funksion të rimëkëmbjes ekonomike pas përhapjes së pandemisë.




## Banka Botërore mbështet ministrin Reçica për reformat e ndërmarrë

**PRISHTINË, 16 KORRIK (ER)** - Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skënder Reçica, të enjten ka zhvilluar një takim virtual me drejtorin e ri të Bankës Botërore për Kosovë, Massimiliano Paolucci, me të cilin ka diskutuar lidhur me situatën e krijuar ekonomike dhe sociale në vendin tonë si pasojë e

pandemisë Covid-19. Reçica e ka njoftuar drejtorin e ri të Bankës Botërore për reformat e ndërmarrë nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, me theks të veçantë reformën pensionale dhe vazhdimin e reformës së asistencës sociale, për të cilat edhe ka marrë përkrahjen e

plotë nga ai.

Gjatë këtij takimi virtual, i pari i MPMS-së e ka falenderuar drejtorin e ri të BB-së për mbështetjen e madhe që ndër vite Banka Botërore i ka dhënë shtetit tonë dhe tanë që po vazhdon të japë kontributin e saj në funksion të rimëkëmbjes ekonomike pas përhapjes së pandemisë.



# Pas bllokimit të xhirollogarive, ministri Kuçi takoi bordin, menaxhmentin dhe Sindikatën e Telekomit

EPOKA  
ERE Albulena S. MAVRAJ

**PRIŠTINË, 16 KORRIK** - Ministri i Ekonomisë dhe Ambientit, Blerim Kuçi, ka pritur të enjten në takim informues dhe raportues bordin, menaxhmentin dhe Sindikatën e Telekomit të Kosovës. Temë bosht e takimit të tyre ishte gjendja e krijuar së fundi në Telekomin e Kosovës, pas bllokimit të xhirollogarive bankare nga përmbaruesi privat.

Ministri Kuçi ka kërkuar nga drejtuesit e organeve të Telekomit që të raportojnë në tërësi përrnjë e këtij rasti dhe për hapat që janë ndjekur në se cilën fazë. Gjithashtu, nga menaxhmenti u kerkua të raportohet përfomancën e tanishme të kësaj ndërmarrje publike.

Përpas diskutimit, ministri ka kërkuar nga bordi i ndërmarrjes që të propozojnë rekondime për dalje nga gjendja e bllokimit të xhirollogarive bankare dhe përvazhdimin tutje të funksionimit të ndërmarrjes. Ndërsa Sindikatës së Telekomit i ka thënë se bashkëndjejnë me punëtorët, të cilët janë të shqetësuar përsit situatën, pikërisht në këtë kohë pandemie.

Ministri Kuçi përsëri është zotuar se me të gjitha mundësitet ekzistuese do të bëhet zgjidha më e mirë. E pas takimit, ka reaguar bordi i përkohshëm i drejtoreve të Telekomit të Kosovës Sh. A. lidhur me bllokimin e llogarive bankare të TK-së. Ai ka kërkuar nga institucionet që të gjendet një rrugëdalje nga kjo situatë. "Ky bllokim i llogarive bankare ka ndodhur si rrjedhojë e arbitrazhit të humbur në vitin 2016 ndaj 'Dardafon.net' L.L.C., e njojur për opinionin publik edhe si 'Z-Mobile'. Në takim ne e shprehëm shqetësimin tonë lidhur me këtë emergjencë në të cilën ndodhet Telekomi dhe kerkuan mbështetjen e Ministrit për daljen nga kjo situatë, me të vetmin qëllim përtak evituar bllokimin e Telekomit me pasoja të pariparueshme si përekonominë e Republikës së Kosovës, po ashtu edhe interesat kombëtare", thuhet në komunikatën e bordit të Telekomit. "Ne si bord i përkohshëm, që nga emërimi në këtë detyrë, kemi ndërmarrë hapa dhe vendime konkrete të cilat kanë ndikuar sadopak në përmirësimin e gjendjes së rendë të përgjithshme në të cilën ndodhet Telekomi. Sa i përket procesit në lidhje me bllokimin e llogarive bankare, ju sigurojmë se nga ana e



Telekomi është ndërmarrë çdo hap i mundshëm, megjithatë bllokimi i llogarive është rrjedhojë e problemit të krijuar para shumë viteve dhe i paevituar. Ne anëtarët e bordit i kemi shteruar të gjitha veprimet konkrete në këtë drejtim në baza të përgjegjësive dhe detyrave fiduciare që na janë ngarkuar. Përkështetje, si

të vetmen mundësi për të dalë nga kjo situatë e shohim përfshirjen e aksionarit. Në takimin e sotëm ne hasëm në përkrahjen e ministrit Kuçi dhe u siguruam që Ministria dhe Kuçi do t'i ndërmarrin të gjitha hapat dhe veprimet konkrete përkështetje, duke kontribuar që të shpëtohet

Telekomi i Kosovës Sh. A. I sigurojmë qytetarët e Republikës së Kosovës, se bordi është duke punuar ngushtë me menaxhmentin e Telekomit të Kosovës, aksionarin dhe çdo organ tjetër kompetent në mënyrë që ta tejkalojmë sa më shpejt këtë situatë", është theksuar në komunikatën e bordit të Telekomit.

## Ministri Krasniqi sheh nga afër zbatimin e masave kundër Covidit

**PRIŠTINË, 16 KORRIK (ER)** - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë (MTI), Vesel Krasniqi, së bashku me kryeinspektorin Lulzim Syla, kanë vizituar disa biznese përtakësuar edhe përsit situatën e masave kundër Covid-19, si dhe me sfidat me të cilat po përballen bizneset gjatë pandemisë.

Ministri ka kërkuar nga bizneset të tregohen të kujdeshme për zbatimin e masave. "Ne dolëm për të parë se sa bizneset tona po i respektojnë këto masa. Ne kemi rritur inspektimet në tërë vendin dhe në tërë komunitat. Pas heqjes totale të masave dhe pas kthimit të tyre ka qenë një vështirësi me të cilën inspektorati ynë është përballur. Ka pasur probleme, janë shqiptuar edhe gjoba, por tanë ajo që po shohim është se inspektorët

kanë bërë një punë të madhe", ka deklaruar ministri.

Ministri Krasniqi është interesuar edhe për cilësinë e ushqimit, në veçanti për produktet e qumështit, pas ankesave që ka marrë nga shoqata të ndryshme të kësaj fushe. "Disa takime që i kam pasur me shoqata të ndryshme kanë shprehur shqetësimet e tyre përcilësinë e disa produkteve të importuara, prandaj ne jemi këtu, bashkë me ekspertë të fushave, përtakësuar edhe sasinë. Kemi thënë në fillim që fokus kryesor do të jetë mbrojtja e prodhuesve vendorë dhe konsumatorët", ka thënë ministri Krasniqi, i cili ka shprehur kënaqësi përspektivën e masave si dhe përrënditjen e ushqimeve dhe përvendosjen e flamujve të origjinës së produkteve.



## Nis rregullimi i rrugës 23-kilometërshe Pleshinë - Kashtanjevë

**FERIZAJ, 16 KORRIK (ER)** - Komuna e Ferizajt ka bërë me dije se ka nisur rregullimi i rrugës 23-kilometërshe Pleshinë - Kashtanjevë, e cila konsiderohet arterie e rëndësishme rrugore e turistike që lidh këtë komunë me atë të Shtërpçës.

Për t'i ndjekur nga afër punimet në këtë projekt, ka dalë edhe kryetari i Ferizajt, Agim Aliu, nënëkryetari i komunës, drejtoret komunalë si dhe financuesja e këtij projekti, Ministria e Infrastrukturës, konkretisht zëvendësministri Xhavit Zariqi.

Për këtë projekt, drejtori i Urbanizmit dhe Mjedisit, Lulzim Aliu, ka thënë se është investim strategjik, tejet i rëndësishëm, që lidh dhe zhvillon dy komuna. "Është një prej projekteve të rëndësishme të komunës që po realizohet në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës. Ky projekt realizon shumë qëllime të komunës, së pari e lidh Ferizajn me Shtërpçën, bille i afrohet edhe Suharekës në bazë të projektit. Është një projekt 23-kilometersh dhe ka synim zhvillimin e bujqësisë dhe blegorisë. E afron Kashtanjevën

shumë afër Ferizajt. Duke u bazuar në faktin që në Ferizaj jetojnë shumë banorë të Kashtanjevës, për kashtanjevasit ky është një projekt shumë i rëndësishëm, edhe përfaktin e ndikimit në turizëm", ka thënë drejtori Aliu.

Falënderues për këtë projekt janë shprehur edhe banorët e Pleshinës. Kryetari i këtij fshati, Sabedin Mustafa, ka thënë se ky është një projekt i qëlluar që do ta rrisë vlerën e kësaj zone dhe të krijojë mundësi të reja për banorët. Ky projekt pritet të realizohet brenda tre vjetëve dhe kap vlerën e 3.5 milionë eurove.



## Komuna e Fushë-Kosovës, memorandum mirëkuptimi për menaxhimin e mbeturinave



**FUSHË-KOSOVË, 16 KORRIK (ER)** - Komuna e Fushë-Kosovës, e përfaqësuar nga kryetari i saj, Burim Berisha, ka lidhur një memorandum të mirëkuptimit me Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH dhe Organizatën Joqeveritare Green Art Center - Prishtina (GAC), lidhur me projektin "Pilotimi i kompostimit në shtëpi në 6 komunat e Kosovës".

GIZ-i është i obliguar që ta mbështetë Komunën e Fushë-Kosovës, si fitues e projektit, me infrastrukturë 266 komposterë shtëpiakë dhe asistencë teknike gjatë implementimit të projektit. Ndërsa Komuna e Fushë-Kosovës, po ashtu, është i obliguar ta implementojë dhe bashkëfinancojë në partneritet me GIZ-in projektin "Pilotimi i kompostimit në shtëpi në 6

komunat e Kosovës" në përpunje me vetë kontributin e premtuar më parë në shumë prej 4 000 eurove.

Në anën tjeter, Green Art Center - Prishtina (GAC), si organizatë mbështetëse e kontraktuar nga GIZ-i, është e obliguar t'i ofrojë komunës mbështetje teknike gjatë implementimit të projektit "Pilotimi i kompostimit shtëpiak në 6 komuna të Kosovës". Ky memorandum do të hyjë në fuqi pas nënshkrimit nga përfaqësuesit e GIZ-it, GAC-it dhe Komunës së Fushë-Kosovës derisa të përfundojë implementimi në pajtueshmëri me të gjitha palët kontraktuale.

## Brenda dy muajve Skenderaj bëhet me fontanë moderne

**SKENDERAJ, 16 KORRIK (ER)** - Komuna e Skenderajt ka bërë me dije se brenda dy muajve në parkun "Idriz Reci" do të ndërtohet një fontanë moderne. "Qytetit tonë historik brenda dy muajve do t'i shtohet edhe një projekt kreativ dhe shumë i rëndësishëm për nevojat e qytetarëve të Skenderajt dhe rrithinës. Një çezme publike, me fontanë moderne, e vendosur në parkun 'Idriz Reci', një

hapësirë atraksioni për banorët dhe vizitorët që vizitojnë qytetin tonë. I projektuar dhe trajtuar edhe në aspektin historik dhe mjedisor, ku qytetarët, përvèç që do të shërbehen me ujë, si burim i jetës, ata mund ta shfrytëzojnë atë edhe si hapësirë rekreative", ka njoftuar komuna e Skenderajt.

Kjo komunë ka theksuar se i tërë ky projekt është dhuratë (donaçion) nga humanisti dhe miku i

Skenderajt, Sali Ajdini nga Gostivari, kurse projekti është dizajnuar dy studentë të arkitekturës, Ibrahim Zabeli dhe Elion Ismajli. Me këtë rast, kryetari i Skenderajt, Bekim Jashari, ka falënderuar humanistin Ajdini për financimin e këtij projekti. "Në emër të qytetarëve të komunës sonë, falënderoj mikun tim, Sali Ajdini, për financimin e këtij projekti në qytetin tonë", ka thënë Jashari.



## Komuna e Drenasit vazhdon aktivitetet për largimin e deponive ilegale



**DRENAS, 16 KORRIK (ER)** - Komuna e Drenasit, përkatësisht Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergencës, është duke vazhduar aktivitetet për largimin e deponive ilegale nga territori i kësaj komune. Këtë herë kjo drejtori ka vazhduar largimin e deponisë te pishat, afër lag-

jes "Nishori" në Komoran. "U bëjmë thirrje të gjithë qytetarët, që mbeturinat inerte t'i dërgojnë në deponinë inerte në Llapushnik, me qëllim që t'i ruajmë hapësirat e gjelbëruara. Kjo deponi është caktuar nga Komuna e Drenasit për hedhjen e mbeturinave inerte nga qytetarët,

në mënyrë që të parandalohet krijimi i deponive ilegale me përmbytje inerte. Mënyra më e mirë për ta parandaluar pandeminë është mbrojtja e natyrës për një të ardhme të shëndetshme. Këto aktivitete do të vazhdojnë edhe në ditët në vijim", ka njoftuar komuna e Drenasit.

# ÇFARË KËRKON EVROPA NËPËRMJET ZOTËRI MARTYT? (9)



Shkruan: Kudusi LAMA

Çfarë kërkon zotëri Marty? Ai ka mundësi të jetë edhe i drejtë, por nuk ka dëshirë të jetë i tillë. Nuk dua të besoj se ai është politikan laboratori, që nuk kupton se si lëviz shoqëria njerëzore jashtë laboratorit të tij. Nuk kanë humbur vetëm serbë, kanë humbur dhjetë mijë herë më shumë shqiptarë. Sic duket, shqiptarët e humbur serbët i kanë marrë për t'u ngrënë mishin e bluar kockat. E kjo nuk është problem për zoterin Marty, ndërsa shqiptarët i paskan marrë për t'u grabitur disa organe jetësore. Kjo është shumë problem për zoterinë Marty. Çuditë nuk kanë të sosur. Sa mbaron një çudi, lind një e dytë.

Ka mundësi që nëse do të dalë edhe pas 50 vjetësh se dikush bën një veprimtari të paligjshme, do t'ia lidhin kokën në kohën e luftës. Kështu ndodhi edhe me një të quajtur klinika "Medikus" në Prishtinë, që doli diku nga viti 2008, se ishte krijuar për transplantime dhe kishte brenda punës së vet veprimtari kriminale, ku u aludua se udhëheqësit e Luftës Çlirimtare të Kosovës duhet të ishin njohur "patjetër" me pronarët e kësaj klinike që në kohën e luftës në mënyrë të fshehtë. Këto janë absurditete, që me të drejtë duhet të përbulen e nuk duhet të merremi me ta. Por, ja që po na bëjnë dëm kombëtarisht e po na krijojnë probleme në arenën ndërkombëtare e kombëtare. Për këtë, duhet të ndalemë e t'i analizojmë këto ndodhi, për ta sqaruar sadopak opinionin për të vërtetën e këtij akti.

Duke shfletuar lajmet e kohës, pas daljes publike të reportit të Dick Martyt, kam lexuar se: "Gjykatësi i Bashkimit Evropian, Victor Paradal, ka kryesuar të enjen seancën dëgjimore për konfirmimin e akuzave të ngritura kundër shtatë kosovarëve, të dyshuar se janë pjesë e një rrjeti ndërkombëtar të përfshirë në trafikimin e organeve njerëzore. Në seancën që u mbajt në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, prokurori i BE-së, Jonathan Ratel, ka thënë se "njerëz të varfëri ishin sjellë në Kosovë nga vendet e jashtme, me premtimë të rrejshme për të marrë pagesa për veshkat e tyre, organe këto

të cilat pastaj u janë shitur pranuesve për transplantime të paligjshme". Ratel ka thënë se mjeku turk Yusuf Sonmez "ka qenë i përfshirë dhe është pjesëmarrësi kyç në operacionet" që janë bërë në një klinikë private në periferi të Prishtinës, e cila mban emrin "Medicus".

Marrë në internet (<http://www.telegrafi.com/?id=2&a=12208>)

Është interesant fakti që nëse ka një veprimtari të tillë antilogjore, në Kosovë, siç ka edhe në gjithë vendet e tjera të Evropës e të botës, pse duhet të dilet politikisht në përfundime që nuk dilet juridikisht? A mban përgjegjësi ky njeri për atë që ka thënë? Si mund të vihet në bankën e akuzës ky njeri që mashton duke hedhur baltë mbi një komb të tërë e gjithë historinë e tij?

Çfarë kërkon zotëri Marty? A ka ai ndonjë farë ndjenje përvlerën e shqiptarëve? Çfarë ka studiuar deri tanë për shqiptarët dhe historinë e tyre? A ka gjetur ky zotëri në kërkimet e tij që luftëtarët e UÇK-së të kenë vrarë ose zhdukur fëmijë, gra, pleq e plaka, të sëmurë nëpër spitale, qytetarë në rrugë etj? Po, janë vrarë ushtarë, pra janë vrarë burra, lufta zotëri Marty bëhet nga burrat e ata në luftë edhe vriten. Në luftë nuk bëhet dashuri, aty vriten njerëz luftëtarë në të dy anët e frontit.

Unë e di se Serbia është në agresion të pandërprerë kundër Kosovës e gjithë trojeve shqiptare. Por, pse, zotëri Marty të jetë luftëtar i këtij agresioni, këtë unë nuk arrij ta kupotoj. Thuhet që le të hapet debat përkëtë temë, mirë është, sepse do të ndërgjegjësoheshin ata që duan të ndërgjegjësohen se kjo shpifje është e pavërtetë. Ne jemi shqiptarë, edhe atë që na ka vrarë djalin e vetëm kur na ka ardhur në shtëpi e kemi marrë në mbrojtje. Kurrë nuk ka ndodhur ndër shqiptarë me marrë njerëz të gjallë, sado armiq e me i vra tinëzish në shtëpinë tonë e në tokën tonë. Ky është një akt ligjor-zakonor që prej lashtësisë për shqiptarët. Edhe pa dashje kur ka vrarë një njeri në shtëpi të vet, shqiptari e ka braktisur atë shtëpi se nuk ka jetuar dot bashkë me gjakun e njeriut të derdhur në vatren e tij. Ndërsa sot jemi nën vlerësimet e zotëri Martyt që po na ngatëron, po na ndynë, po na akuzon, për të përbaltur jo vetëm një fragment historik lavdie kombëtare, por gjithë traditën e këtij kombi.

Kjo çështje dihet që do të hulumtohet dhe do të kërkohet ballafaqimi me argumente për

ta vërtetuar akuzën. Dhe shqiptarët institucionalisht janë deklaruar si popull i qytetëruar, se janë të gatshëm t'i nënshtronë çdo hetimi ndërkombëtar. Për këtë edhe pa hezitim u pranua edhe ajo gjykatë ndërkombëtare që ka përmision ta njollosë UÇK-në. Por, a do të përfillen argumentet? Mbetet të shihet. Megjithatë shqiptarët duhet të kenë bindjen se djemtë e Luftës së Lavdishme Çlirimtare të Kosovës, sado të akuzohen do të dalin të pafajshëm, gjykata dhe të gjithë ata që fshihen pas saj do ta njollosin veten. Askush nuk do të mund të na nëpërkëmbë zakonet tona që na kanë sjellë udhëve të shkujve krenarë.

Megjithëse zakonisht, praktika

mirë, se sido që të vijë puna, shpifjet e tij do të mbeten në agjendë të politikës evropiane për këtë periudhë të gjatë. Për këtë edhe lind pyetja: çfarë kërkonte të arrinte zotëri Marty? Një pyetje që as prej këtij zotërie vetë nuk mund të marrë përgjigje morale. Ajo mund të marrë vetëm një përgjigje të pa moralshme, që ka të bëjë me justifikime, apo shprehje dashurie për shqiptarët siç ka bërë edhe ky zotëri, për hatër të të cilëve është i gatshëm të bëjë sakrificën më të madhe e të përpinqet t'u njollosë historinë e t'u nëpërkëmbë lavdinë.

Qëllimi im nuk është t'i mbushi mendjen botës se zotëri Marty shpifi. Se këtë ata e dinë shumë mirë të gjithë. Por t'u them shqiptarëve që të mos

Marty? Çfarë kërkon ai kur të gjithë e njohin kundër shqiptarizmin e tij? Ku ka dëshirë të arrijë? A mos me ndërgjegje i bën deklarata të tillë. Nëse është kjo e fundit, ai meriton t'i kërkohet llogari. Realisht të tjerët si zoti Marty me akuza e shpifje, ndërsa ne me qytetari nuk ka balancim të të drejtës. Prandaj, nëse ky zotëri akuzon pa të drejtë, ne e kemi për detyrë t'i kërkojmë atij të japë llogari deri në një për çdo fjalë që nxjerrë nga goja. Ne nuk duhet të pranojmë edhe megafonët serbë nëpër Evropë, vetëm pse ne duhet të sillemi si të kultuar duke duruar marrëzinë. Duke menduar ne se nuk duhet reaguar përfekte kulture, bota po merr si të mirëqena shpifjet. Në raste të tillë nuk ka vlerë as qetësia prej të pafajshmi, as injorimi i shpifjes së neveritshme, ka vlerë e vërteta, për të cilën ne duhet të ndalemë e të mos lëshojmë pe. E vërteta nuk mund të jetë gjithnjë në anën e të fuqishmit. Ajo duhet të jetë me të drejtën dhe të pafajshmin.

Para disa kohësh kam shkëputur nga një shkrim këtë citim: "Nëse do të analizoheshin të gjitha shtrembërimet, shpifjet e botuara, të lexuara, të thëna takime kokë më kokë, sekrete apo publike, do të shihej se kundër nesh Serbia ka nisur një fushatë, që ka efektet e një agresioni. Faktori serb në këtë periudhë e vazhdon luftën kundër shqiptarëve me mjete tjera. Vazhdimi i kësaj politike, të një lufte të ftohtë, dëshmon se ata kanë qëllime të njëmendta armiqësore. Sa jemi të vetëdijsëm për këtë kanosje? Do të thosha me zhgënjim, aspak!"

Prandaj do të thosha se qëndrimet dhe veprimet me vlerësimet individuale të Martyt janë absurde, por të marra seriozisht nga organizatat evropiane dhe segmentet e ndryshme të klaneve proserbe ato bëhen shumë të dëmshme. Çfarë kërkon pra zotëri Marty? Kjo është e pakuptueshme përmua. Nuk arrij të arsyetoj një veprim të tillë, kur kam parasysh një njeri të shkolluar, që pretendon se është funksionar evropian, që flet në emër të Evropës, që pretendon se ka një vizion qytetar, që ka mundësi të bëjë vepra të mira, por që me deklarimet dhe qëndrimet e shpifjet për të krijuar mostra shqiptare, kur realisht shqiptarët janë bërë viktima deri në ekstrem, nuk mund të gjendet arsyetim tjetër veçse të jetë i paguar i Serbisë, për ta rritur zërin e shpifjeve të saj. (Vijon)



ka treguar se sado që të ketë të vërteta, shpifja, në opinionin e gjerë publik dhe politik, është shumë e fuqishme. Ajo nuk shlyhet lehtë në opinion, pavarësisht se shlyhet ligjërisht. Ka raste kur një individ vihet nën akuzë si terrorist, por faktet tregojnë se ai nuk ka asnjë lidhje me akuzën e ngritur. Gjykata i jep pafajësinë, mund të marrë edhe dëmshpérblime, por në opinionin publik dhe politik ai mbetet një "terrorist", a këtë po tentojnë të arrijnë akuzuesit me të akuzuarit prej tyre të luftëtarëve të UÇK-së. Më duket se po.

Po duhet ditur se, kur bëhet fjalë për përmasa të tillë, ku luhet me historinë e një kombi? Këtu çështja është shumë delikate. Këtu përpjekja duhet të jetë maksimale e të gjithë shqiptarëve për të vërtetën dhe të drejtën, pasi akuzuesit shkijnë me mendimin se: as që mund të mendohet, se do të ketë një pastrim të këtyre situatave, të mbingarkuara politikisht me shpifje nga më të rëndat, që i bëri me raportin e tij famëkeq zotëri Marty në emër të Evropës.

Zotëri Marty e ka ditur shumë

# Nga java e ardhshme, Franca e bën tē detyrueshme veshjen e maskës



Paris, 16 korrik - Kryeministri i Francës, Jean Castex, ka thënë se nga java e ardhshme veshja e maskave në ambiente të mbyllura do tē jetë e detyrueshme si masë përfrenimin e përhapjes së koronavirusit. Një ditë më herët, presidenti i Francës, Emmanuel Macron, ka deklaruar se ky detyrim do tē hyjë në fuqi nga 1 gushti. Por, Castex i ka thënë tē enjten

Senatit francez se afati është zhvendosur përpara, pas sugjerimeve se gushti mund të jetë vonë.

Në rajonin veriperëndimor të Francës, Majene, urdhri hyn në fuqi prej sot, për shkak të shqetësimeve përrritjen e numrit të rasteve me koronavirus.

Deri më tani, në Francë, veshja e maskës ka qenë e obligueshme në transport publik dhe aty ku distanca fizike ka qenë e pamundur.

Franca është në mesin e vendeve më të prekura në Evropë nga koronavirusi. Mbi 210 000 njerëz janë infektuar atje, ndërsa mbi 30 000 kanë vdekur. Në gjithë botën, koronavirusi ka prekur mbi 13.5 milionë njerëz. Prej këtyre, mbi 584 000 kanë vdekur, ndërsa mbi 7.5 milionë janë shëruar.

## Trumpi e zëvendëson menaxherin e fushatës

**UASHINGTON, 16 KORRIK** - Përballët një beteje të ashpër rizgjedhjeje, presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, e zëvendësoi menaxherin e tij të fushatës zgjedhore. Trump ka thënë se në vend të Brad Parscale do tē vijë Bill Stepien, i cili ka qenë drejtør në terren i fushatës zgjedhore të Trumpit në vitin 2016.

Parscale, i cili thuhet se u fajësua nga rrëthi i brendshëm i Trumpit për një tubim me pak njerëz në Oklahoma, muajin e kaluar do tē qëndrojë si këshilltar i lartë.

Sondazhet e opinionit tregojnë se Trump qëndron pas kundërshtarit demokrat, Joe Biden, në prag të zgjedhjeve presidenciale të nëntorit. "Brad Parscale, i cili ka qenë me mua për një kohë shumë të gjatë dhe ka udhëhequr strategjitet tona të jashtëzakonshme digitale dhe zhgënjenjese.

të dhënavë, do tē mbetet në atë rol, duke qenë këshilltar i lartë i fushatës", ka shkruar Trump në "Facebook".

Parscale thuhet se është marginalizuar javën e fundit për shkak të dështimit të një tubimi zgjedhor në Tulsa të Oklahomas.

Vajza e presidentit, Ivanka Trump, dhe burri i saj, Jared Kushner, të dy këshilltarë të Shtëpisë së Bardhë, raportohet se e kanë fajësuar Parascalen përdështimin.

Parscale ka thënë se më shumë se një milion njerëz janë regjistruar përmarrë pjesë në tubim por, sipas Departamentit Lokal të Zjarrit, tubimi është ndjekur nga më pak se 6 200 veta. Pas tubimit, Parscale ka fajësuar një portë të bllokuar të sigurisë, protestuesit dhe mediat përpjesëmarrjen zhgënjenjese.



## Fauci pret që ShBA-ja ta ketë vaksinën kundër koronavirusit në fund të 2020-s

**NJU JORK, 16 KORRIK** - Drejtori i Institutit Kombëtar të Shteteve të Bashkuara për Alergji dhe Sëmundje Infektive, Anthony Fauci, ka thënë se pret që ShBA-ja ta ketë vaksinën kundër koronavirusit deri në fund të këtij viti. "Ndihem mirë me orarin e parashikuar", ka thënë Fauci përi agjencinë e lajmeve "Reuters".

Komentet e tij pasojnë të dhënat premtuese të fazës së hershme të testimit të një vaksine nga kompania bioteknike amerikane, "Moderna".

Vaksina, që është zhvilluar nga shkencëtarët e institutit që udhëheq Fauci, pritet të hyjë në fazën përfundimtare të testimit në fund të këtij muaji. Fauci ka theksuar se rezultatet e



"Moderna" janë veçanërisht premtuese, sepse vaksina duket se ofron llojin e mbrojtjes që shihet në një infeksion natyral. "Një nga gjërat që shpresoni është që vaksina juaj të ketë një përgjigje që mund të krahasohet me një infeksion natyral sepse, teorikisht, vaksina më e mirë që

ndoshta mund të krijoni ndonjëherë, është infeksioni natyral", është shprehur Fauci. Fauci ka deklaruar se nuk është i shqetësuar me idenë se Kina mund ta sigurojë vaksinën më parë. "Nuk do ta ketë shumë më shpejt se ne. Kjo është e sigurt", ka thënë Fauci.

## Ekonomia e Kinës i kthehet rritjes, shmang recessionin

**PEKIN, 16 KORRIK** - Ekonomia e Kinës u rrit në tremujorin e dytë të këtij viti, pas rënies së thollë në çerekun paraprak. Byroja Kombëtare e Statistikave ka njoftuar lëtë enjten se ekonomia e dytë më e madhe në botë është rritur për 3.2 për qind në periudhën prill-qershor, duke i hedhur poshtë pritjet e analistëve për 2.5 për qind rritje. Rritja pason tkurrjen për 6.8 për qind në tremujorin e parë, kur Kina është bërë vendi i parë në botë që është goditur nga pandemia e koronavirusit. Me shifrat e fundit, Kina shmang hyrjen në recession teknik, i cili ndodh pas dy periudhave të



njëpasnjëshme të rritjes negative. Kina, në më të madhe, e ka frenuar përhapjen e koronavirusit dhe i ka lehtësuar masat e izolimit gjatë dy muajve të kaluar, por ekonomia vazhdon të rimëkëmbet ngadalë, përkundër hapave të politikëbërësve përtat rritur stimulimin.

## Banka Qendrore Evropiane u kërkon udhëheqësve të veprojnë urgjent në ekonomi

**FRANKURT, 16 KORRIK** - Banka Qendrore Evropiane (BQE) u ka kërkuar liderëve evropianë të ndihmojnë ekominë duke gjetur pajtim për një fond që do t'i mbështeste rajonet më të

goditura nga pandemja e Covid-19. Presidentja e BQE-së, Christine Lagarde, ka thënë se "një përpjekje ambicioze dhe e koordinuar" nga qeveritë

"mbetet kritike". Të premten drejtuesit evropianë do të diskutojnë një plan të përbashkët përimëkëmbjen pas pandemisë. Komisioni Evropian ka

propozuar një fond të rimëkëmbjes prej 750 miliardë eurosh. Por, ka mosmarrëveshje mes vendeve anëtare se çfarë kushtesh duhen plotësuar përtë pasur qasje në këtë fond.





The banner features the RC Cola logo at the top left, followed by a large yellow box containing the text "ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS". Below this, a blue box lists the "Quality & Sales Award Recipients" in alphabetical order. To the right, there are images of a blue RC can and a dark plastic bottle of RC Cola.

**Quality & Sales Award Recipients**  
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Qualtiy
- ★ Fludi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Industria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



The advertisement features a circular tin of MEKA Halal Food Pashtetë Pule. The tin is orange with a white lid, showing a slice of the pate with herbs and a red pepper. Text on the tin includes "MEKA HALAL FOOD", "PASHTETË PULE", "gluten free", "100% mish puk", "cili e garantuar", and "pa konservues". The background is a stylized orange and white flame-like pattern.



# Identifikimi traumatik i kohës në novelën 'Katundi me gjuhë të fshehtë' të Martin Camajt

Nga: Agron TUFA

## PREMISË

Koha dhe gjuha janë dy nga polet më të fuqishme që mpiksin universin letrar të Martin Camajt. Edhe kryetema e Camajt, në krejt krijimtarinë e tij, është fati i frysorit në vorbullën e kohës, fati i qenies e fshemë përbullë kohës, apo më saktë, habia se çfarë është në gjendje të bëjë koha me njeriun. Një kredo që do t'i shkonte më përshtat një filozofie sa një shkrimitari, por që Camaj e shpërnguli këtë diskurs në veprën letrare nëpërmit imazhit të njeriut të vettuar, ishullor, edhe në metropolet e zhurmshme të qyteteve të Evropës. Nga kjo pikëpamje, teza e hedhur ku përvjedhata në shtyp e ku me gjysmëzëri "nën banakun" e rretheve shkencore e letrare se krijimtaria e Camajt "është disi jashtë mode, rurale", shpreh ose moskuptim t'pashpresë, ose ligësi të përllogaritur.

Në novelën e Camajt "Katundi me gjuhë të fshehtë", ndryshe nga poezitë dhe prozat e tjera të tij, ndeshemi me përfjetimin e kohës si kategori psikotraumatike. "E fshehta/fshehtësia" si dominante në këtë novelë lejon

shfaqjen e parabolës së një udhëtimi dhe bujtjeje në viset e vdekjes dhe kthimin prej andej me një vetëdije të traumatisuar dhe të shprishur mbi rrjedhën racionale të kohës, të njohur në filozofinë dhe shkencat evropiane si "shigjeta e kohës". "Fshehtësia" në novelën e Camajt aq sa lejon të shfaqet, po aq mbështjell me mjegull shenjat e përvijimit dhe zbardhjes së saj. Në këtë "fshehtësi" lejohet përgjysmë të shfaqet ideja ciklike (karakteristike përmirë) e kohës – nga shtatori në shtator-kohë që përkon me kthimin e vazdureshëm të personazhit në të njëtin plazh bregdetar. Nga ana tjetër, kemi fshehjen e saktesimit kalendarik të kohës (viti), çka do t'i jepte kohës karakter linear.

Në dikotomitë "e fshehtë/ e dukshme" – e fshehtë mbetet hapësira, toposi i papercaktuar i ngjarjes (një plazh diku buzë detit Jon), katundi i papercaktuar mbas majëmalit, përmirë cilin dinë shumë gjëra përvëç emrit të tij, disi krejt në fryshtë e prozave të Franc Kafkës. Mandej kemi emrat e e papercaktuar të personazheve dhe identitetet e tyre (i huaj, vendasit). Të dukshëm na jepen kuvendimet fantazmagorike të heroit me shembëlltyrën e rigjetur, Florën, një ish e

dashur e tij e para njëzet vjetësh, të cilën e ndesh sapo shkel në katundin misterioz. Të dukshme janë dy kategori-simbole në novelë: Gjuha (e fshehtë) dhe Koha (e fetishizuar, pas përvjoejës së bujtjes te vdekja). Ne do të përpinqemi të analizojmë përfjetimin e traumatisuar të kohës në novelë, në rrekje përmirë kërkuar "gjuhën e fshehtë", duke e parë përfjetimin e kohës në këndvështrimin psikologjik, përvijimin e simboleve mitike në përvojën e traumës. Duke iu referuar K. L. Strosit se "miti është një makinë përmirësimi e kohës", analiza jonë do të përqendrohet në kërkimin alegorik të rrënjeve të identitetit të kallura në kategoritë e gjuhës dhe kohës, si dhe përpjekjen e tendosur të qenies së njeriut vëmtitar përmirë rezistuar karakterit dezintegrues të ndarjes nga gjuha e tij.

## "ATJE... MAS... FLASIN SI JU"

Novela nis me shprehjen: "Ata atje nalt flasin si ju" dhe kur heroji narrationit gjendet mes atij vendi iluzor, ku pritet të "flasin si ai", flet me shembëlltyrën e dashurisë së tij të rinisë: "Ka që randësi qenka përmirë kjo rrëthanë, me u marrë vesh

në gjuhën e djepit?" "Ashtë pak me thanë e djepit: e tamblit të gjiut! Çdo fjalë e saj përqohet si nëpër tejza të një atthie magjepsësë në veshë dhe më zgjon në qenien time ndija kuptimi të vërvetes e të botës mbarë. Nuk më zen besë?"

Fraza e parë e novelës me të cilën vendasi i huaj i drejtobet heroit – "Atje nalt flasin si ju" – na fut menjëherë në një fushë të polarizuar kuptimore. Më së paku kjo fjali e parë e ndërgjegjëson lexuesin se protagonisti qendor i rrëfimit a) është i huaj, b) ndodhet i prerë nga mjedisë i gjuhës amtare dhe c) (më vonë, pasi njihemi me veprimtarinë e tij si mbledhës i reliktive shpirtërore të emigruesve) – ai e gjurmon gjuhën e tij si një relikt të rrallë etnografik. Personazhet e rrëfimit njihen turbull. Përveç të huajt, është vendasi i parë me të cilin i huaj takohet çdo shtator në atë gjë bregdeti jonik ku e ka bërë traditë të kalojë pushimet.

## "MBAS MAJE"...

Që në faqet e para të tekstit protagonistin e rrëfimit, përkundër e tretur ndërmjet aluzione është biseda që ata bëjnë, e pasigurtë është vendndodhja e fshatit të fshehur pas majës së malit, pasi prej bregdetit shihet në majë

emër, por jepet në tekst na jepet "i huaji". I huaj në lidhje me kë? Për dy vendasit ai ka vetëm përshtypjen se dikund janë takuar, por kjo është vetëm se hamendje e pasigurt. I huaji është më i pasigurt se dy vendasit, të cilët duket se e mbajnë mend më mirë atë, meqenëse çdo shtator i kujtojnë atij se "Mbas asaj maje flasin si ju". Më vonë, nga fundi i rrëfimit sqarohet edhe më fort rrëthana, ku del se dy vendasit, i pari prej të cilëve tanë identifikohet me emrin e vet (Sandri), e njohin mirë të huajin, sepse njëri sosh thotë:

"Ky asht një gjurmues", ndërhyjni Sandri "dhe pati ardhë përmirësimi e kohës, mbi emigrimin e banorëve nga vendet pasive, ndërmale, në shmanget. Ky thoshte se donte me u përmisue me ata që lanë vendlindjen e mandej kthejnë përsëri. Im kushri e unë e kemi përcjellë gjithkund ndërmale ato katunde gjysmë të lëshueme, thellë ndërmale". Pra, del se i pasigurtë në kujtesën e vet është vetëm i huaji.

Përveç pasigurisë së identiteteve të personazheve, e pasigurtë dhe e tretur ndërmjet aluzione është biseda që ata bëjnë, e pasigurtë është vendndodhja e fshatit të fshehur pas majës së malit, pasi prej bregdetit shihet në majë

vetëmse antena e televizorit; e pasigurtë është hamendja mbi gjuhën e supozuar që flet ai katund. I pasigurt është vetë i huaji, i cili dyshon se dy vendasit që qëndrojnë në tavolina të ndryshme, kanë ardhë aty kinse për ta ndeshë rastësish. Duket se uji i detit dhe koha e plazhit e thellojnë këtë pasiguri, ngase personazhi qendor, i huaji, nuk është në gjendje të ndërmendë asgjë të sigurtë. Ndërdyshjen e thekson edhe motivimi i tij, fakti i përsëritur për të ardhur çdo shtator në këtë gji deti jugor. Ai i thotë vendasit të dytë (i cili përton me marrë udhën për tek katundi ku mendohet se flitet gjuha e tij, ngase thotë se ka ardhë në det dhe s'i duket "aspak e arsyeshme për me marrë malet"). Por i huaji i thotë: "Për t'u la në det paske ardhë këtu? Në shtator, kur uji e moti ftohen! Me të thanë të vërtetën, unë s'di pse vij në këtë kohë këndej; kush e di, në fund të zemrës trekem gjithnjë me mendimin që ta bjerë puna me u ngjitet te katundi ku u flitka një gjuhë që unë e kuptuakam".

Edhe motivi pse i huaji vjen çdo shtator në këto ujëra, kur moti nuk është i përshtatshëm për plazh, mbetet i paqartë, i fsheetë. Duket se stihia e ujit të ftohtë dhe motit të turbullt nuk sqarojnë, por thellojnë ndërdyshjen, pasigurinë e kujtesës. Vetmia e të huajit që vjen fillikat buzë detit çdo shtator me kujtesë të bjerrur, të sjell ndërmend ujin mitik të Letës, që shplan kujtesën.

Megjithatë, megjithë këto pasiguri, ekziston një këmbëngulje e madhe për t'u ngjitur Majës pas së cilës ndodhet katundi me gjuhë të fshehtë dhe është vendasi i pari që merr vendimin për t'u ngjitur majës, megjithë përtacinë dhe kinse përtësën e vendasit të dytë. Vendasi i parë i mëshon këmbënguljes së vet me lutjen:

"Hajt, mos ma prishni! Ky – tha tue shëne kah i huaji – kush e di a ka për të pasë një rast të tillë në jetë të ndërrrojë katër o pesë fjali me ata që flasin si ai".

Novela do të kishte patur një efekt artistik më të fuqishëm, nëse enigma e bujtjes së të huajit, në katundin me gjuhë si e tij, të mos ishte sqaruar në fund të tekstit prej gjellëbamësit.

Misteri që métihet të mbërrihet në novelë është ekzistencia e një katundi që fliska si protagonisti i rrëfimit, i yshtrur, përkrahur dhe i ndihmuar prej dy vendasve. I gjithë udhëtimi dhe, në përgjithësi veprimi, i ngjan një situate èndrrë apo gjendjeje somnambul. Duket se i vetmi motiv i dy vendasve për ta shpënë të huajin në katundin misterioz, jepet kur njëri prej tyre thotë:

"Se ai, – e tregoi me gisht shokun – edhe unë mjaft dëshiroj me të ndëgjue si ti flet me ata, atje!", por, paradoksalisht, prej po këtij motivi vendasi heq dorë kur makina mbërrin në majën nga ku

duket fshati:

"Pse nuk po vini me mue?"  
"S'jam kurresttar me ditë si flitni. Mandej jam i bindun se sikur të vij me ju, ju pengoj në kuvendim...".

## ISH-E DASHURA ËSHTË GJUHA

Vizitori i huaj ka hyrë tashmë në katund, pamja e të cilit përshkruhet nën zhegun e mesditës pa frymë njeriu dhe me dritare të mbylluna. Protagonisti është gati në të kthyer, "sikur të mos ishte dukë në një ballkon guri gruaja e veshur në zi, me një shall ngjyrë të blerë të mbyllët krahëve. Kjo coi dorën e pëershendet, tue buzëqeshë, burrin të cilët iu kujtue ftyra dhe kryekreje gazi në buzët e saj".

Protagonisti ka takuar papritmas ish të dashurën e vet të viteve studentore, Florën, tashmë një grua e vetmuar, me gjasë, vejushë. Pjesa me madhe e rrëfimit të novelës përshkruan bujtjen e të huajit, deri në mbrëmje, në shtëpinë e ish të dashurës së djalërisë, e cila është larguar një ditë papritmas, pa i dhënë lamtumirë. Pjesa e dytë e novelës i përngajet një epilogu, ku personazhi kthehet në të njëjtën kohë, në të njëjtin bregdet, pas dhjetë vitesh, por që në vetëdijen e tij janë reduktuar në tre vite. Kjo është, si të thuash, edhe pjesa sqaruese dhe ballafaquese në lidhje me iluzionin e bujtjes në një katund që nuk ekziston dhe e përjetimit të ngadalësuar të kohës.

Protagonisti i novelës "Katundi me gjuhë të fshehtë", i huaji, na paraqitet me çregullime kujtese, déjà vu dhe kujtime të rreme. Vektori i përjetimit të kohës së tij, nga është e kthyer dhe vetëdija dhe veprimtaria e tij – është e shkuara, sikundërse është dhe profesioni me të cilin merret – gjurmues i relikteve në zonat e braktisura nga emigrantët. Një prej problemeve qendrore në përvetësimin e Dialogut të tij me Botën është pamundësia për t'u gjendur në kohën e tashme, duke e kredhur atë psikologjikisht kah e shkuara. Pesha rënduese e të shkuarës, vetmia dhe nostalgjia ushtrojnë një trysni tëhuajësuese të subjektit përjetues në të gjithë personazhet e Camajt. I huaji i novelës "Katundi..." është një emigrant i prerë nga mjedisi dhe gjuha amtare, prandaj metafora e kërkuesit të relikteve, është një imazh i afërt e autobiografik i njeriut që përjeton ankthin e përhershëm të nostaljisë, duke shpresuar se koha do ta shndërrojë qenien ose në mjellmë, ose në narciz. Ky udhëtim i ankthshëm fytyrëkthyer nga e shkuara rreh të rizbulojë veten, aq sa i shmanget të tashmes ishullore.

## NJË ODISE TE KALIPSOJA

Herói i novelës "Katundi...", i huaji, shndërrohet në një Odise në kërkim të rizbulimit të dësh-

mive të vërvetes së kërcënuar me harresë. "Malli, dëshirë e përjetës/ e jo mallëngjimi, gurgull frysëshkurtë/ e joshi Uliksin me kthye i kulluem/ atje kah ishte nisë", thotë Camaj në poezinë "Çka i duhej Uliksit Itaka pa grue". Dhe një rol të tillë në novelë, të gjurmimit të Itakës së vet, është për protagonistin e rrëfimit Gjuha. Malli për një takim me gjuhën amtare e motivon udhëtimin e tij në Katundin ku thuhej se flisnin si ai. Por kjo Itakë e gjuhës së fshehtë në katundin iluzor i shfaqet në trajtën e fantazmës së ish të dashurës, me të cilën është ndarë pa lamtumirë, në rrethana jashtë vullnetit të tij. Ky Odise në kërkim të gjuhës, sapo zhëgjenhet nga pamja e ish të dashurës, e ndjen veten të ngjujar, ashtu si Uliksi në siujdhesën e nimfës Kalipso. Meqenëse zhduket iluzioni se në atë katund ka njerëz që flasin si ai, atëherë dhe qëndrimi i tij bëhet i përdhunshëm. "I zhëgjenyer rrinte

ndërdyzash përpëra derës së hapun të grues që quhej Flora, para një labirinti apo hymje burgu, mbas dënimis shumëvjeçar". Gjatë përshkrimit të banesës ka analogji që të ndërmenden shpellën e Kaliposë. Por tashmë pa gjuhën, kjo është një Kalipso e rënë nga vakti, pa asgjë magjike që mban rini në përfjetshme. Ajo nuk është më Kalipsoja e parë, Flora me shtatin e hollë si nepërkë, që qëndronte e fshehur pas kurtinës së tejashme dhe përgatiste ilaçet që i hiqin atij dhimbjet e kokës. Ajo është një Florë e vyshkur, pa efektin magjik të barnave. Kjo fantazmë Kalipsoje s'ka më asgjë me se ta mahnisë Odiseun e saj, e lë të ikë. I huaji largohet nën drithën e hënës, duke e lënë prapa fshatin e çuditshëm pa banorë të tjerë. Protagonistit nuk i kujtohen 7 vjet kohë (aq sa pati qëndruar i ngjujar edhe Odisea në siujdhesën e Kaliposë), pas përvjës së kësaj

bujteje, i cila na sqarohet se ka ardhë si traumë automobilistikë gjatë rrugës për në Katundin "kufas in si ai".

Këmbimi i gjuhës me ish të dashurën dhe mandej zhëgjenjimi i dyfishtë, prej të dyjave, ka sjellë në vetëdijen e personazhit "kundërshtimin e kujtesës" përshtatë vjet, një çregullim të përjetimit linear të kohës:

"Aje ti apo hija e atij që po kujtoj unë? – e pyeti (vendas).

"Ti je ai që na pate lanë në rrugë mua e atë... atë që drejtonte makinën. Tash po më kujtohesh edhe ti! Sandër, të quejnë ty."

"Mbas dhjetë vjetësh të ra ndërmend!...

"Në kohë po gabohesh: s'janë dhjetë, por tri...  
I huaji nuk don të zërë besë, por më në fund, nën dëshmitë e të tjerëve në restorant, gjendet si heroë i Niçes: "Kujtesa ime pohon, se unë e kam bërë këtë: krenaria ime thotë, jo nuk e kam bërë; në fund të fundit, kujtesa ime dorëzohet".





## Do të shqyrtohet mundësia për riaktivizimin e të gjitha sporteve

Ministrja Vlora Dumoshi ka thënë se MKRS-ja së bashku me MSh-në dhe IKShPK-në do ta shqyrtojnë mundësinë për riaktivizimin e të gjitha sporteve, duke pasur parasysh që të gjithë sportistët po ballafaqohen me vështirësi për t'i zhvilluar aktivitetet e tyre

**"Epoka e re"**

**PRISHTINË, 16 KORRIK** - Ministrja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi, ka pritur në takim drejtuesit e Federatës të Bodybuildingut dhe Fitnesit të Kosovës dhe Përfaqësuesit e Palestrave Private Sportive të Fitneseve të Kosovës, me të cilët ka diskutuar për shqetësimet e të gjitha klubeve të Bodibildingut dhe Fitnesit lidhur me ndërprerjen e punës së tyre për shkak të pandemisë.

Ministrja Dumoshi i ka informuar të pranishmit për sfidat me të cilat po ballafaqohet

vendi për shkak të pandemisë dhe u ka premtuar mysafrirëve që në bashkëpunim me Ministrin e Shëndetësisë dhe me Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK-në) do ta shqyrtojnë mundësinë për riaktivizimin e të gjitha sporteve, duke pasur parasysh se të gjithë sportistët po ballafaqohen me vështirësi për t'i zhvilluar aktivitetet e tyre.

Ministrja Dumoshi ka thënë se do të kërkojë që varësish nga kapacitetet dhe rekonditimet e Institutit, të rishqyrtohet çështja e kërkesave që përfaqësuesit e fitneseve parashtruan, sepse edhe federata dhe klube të tjera

sportive, siç janë klubet e notit, që kanë të njëjtat kërkesa, por që vendimmarjen e kanë në dorë Ministria e Shëndetësisë dhe IKShPK-ja. "Jam e vetëdijshme që të gjitha federatat po kalojnë një fazë të vështirë në këtë kohë, për shkak të pandemisë, por ne si ministri dhe unë personalisht si ministre do të angazhohem që t'i adresoj shqetësimet dhe kërkesat e juaja te ministri i

Shëndetësisë", ka thënë ministria Dumoshi. Ndërkajq drejtuesit e federatave e falënderuan ministren Dumoshi dhe stafin e MKRS-së për punën dhe përkrahjen që po jepin për sportin. Ata e informuan ministren për shqetësimet e tyre si dhe për planet e synimet që kanë pas riaktivizimit, kur institucionet relevante e lejojnë një gjë të tillë.

**Ministrja Dumoshi vizitoi Fushë-Kosovën**

Ministrja Vlora Dumoshi, e shoqëruar nga zëvendësministri Halil Matoshi, të enjten e kanë vizituari Komunën e Fushë-Kosovës, për t'i inspektuar investimet që MKRS-ja po bën në këtë komunë. Ministrja Dumoshi e zëvendësministri Matoshi janë pritur nga kryetari i Fushë-Kosovës, Burim Berisha. "Drejtuesit e ministrisë dhe të komunës inspektojan vendin në të cilin pritet të ndërtohet palestra e sportit, afér Pishave të Sllatinës. MKRS-ja investon në çdo komunë, siç është duke investuar edhe në komunën e Fushë-Kosovës. E kemi palestrën sportive, projekt në të cilin së shpejti do të fillojnë punimet", ka thënë Dumoshi.



## Kamerolli: Motiv të luftojmë për 12-shën më të mirë të Kosovës

**PRISHTINË, 16 KORRIK** - Ëndrra e shumë lojtareve të reja, por edhe atyre me përvojë, është bërë realitet. Kosova për herë të parë do të paraqitet me Përfaqësuesen A në konkurrencën e femrave në garat ndërkombëtare. Kosova pritet të marrë pjesë në FIBA Kampionatin Evropian të Shteteve të Vogla që do të organizohet në vitin e ardhshëm në Nicosia të Qipros prej 15 deri



më 20 qershor. Një nga basketbollistet më të talentuara në Kosovë është Enisa Kamerolli. Ajo i është gëzuar lajmit që

Kosova A është formuar dhe do të luajë në arenën ndërkombëtare. "Formimi i Përfaqësueses A për herë të parë është diçka që e mirëpresin të gjitha gjeneratat. Është motiv edhe përgjeneratat e reja të luftojnë për 12-shën më të mirë si dhe të luajmë së bashku me lojtaret më me përvojë. Kjo do të jetë një ndihmë e madhe për ne. Unë këtë ide e vlerësoj shumë nga ana e Federatës së

Basketbollit të Kosovës. Ashtu si edhe për bashkëlojtaret e mia, është një ndërr e bërë realitet", ka thënë Kamerolli për faqen zyrtare të FBK-së.

Në FIBA Kampionatin Evropian për Shtetet e Vogla - Femrat në vitin 2020 janë paraqitur për të garuar: Andorra, Qipro, Gjibraltar, Irlanda, Luksemburgu, Malta dhe Norvegjia, por që është anuluar

për shkak të pandemisë Covid-19. Regjistrimi i shteteve për pjesëmarje në FIBA Kampionate Evropiane në FIBA Europe do të bëhet si zakonisht, pra ndërmjet muajve shtator/totor 2020. FIBA Evropa ka kërkuar nga të gjitha federatat nationale që t'i regjistrojnë ekipe të tyre për vitin 2021, pasi regjistrimet e paraqitura për vitin 2020 nuk do të merren parasysh.

## Xhudistët rezultojnë negativë në testin për Covid-19

**PEJË, 16 KORRIK** - Ekipi i xhudos i Kosovës është testuar për Covid-19 të mërkurën dhe të gjithë xhudistët kanë rezultuar negativë. Lajmin e ka bërë me dije trajneri i Përfaqësueses së Kosovës në Xhudo, Driton Kuka. Ekipi ka udhëtuar në Poreç të

Kroacisë në stërvitje të përbashkëta me reprezentuesit e Kroacisë dhe Slovenisë. "Ekipi ynë elitar të mërkurën u testua dhe që të gjithë dolën negativë. Tashmë kemi udhëtuar në stërvitje të përbashkëta me reprezentuesit kroatë e slovenë

në Poreç të Kroacisë. Ishte kënaqësi bashkëpunimi me profesorin e nderuar Naser Ramadani, i cili është në krye të heronjve mantelbardhë që po përballen në vijën e parë të frontit kundër pandemisë. Falënderim i veçantë për dr.

Adnora Nurboja, udhëheqëse dhe stafit nga Peja për testime. Me njerëz si ju Kosova do t'ia dalë edhe kësaj sfide. T'i përkrahim këta heronj me kujdes të shtuar, t'i ruajmë familjet tonë, miqtë tanë dhe popullin e Kosovës", ka thënë Kuka.



## Dënohen Prishtina, Dallku dhe Bekaj

**PRISHTINË, 16 KORRIK** - Komisioni Disiplinor i Shkallës së Parë në Federatën e Futbollit të Kosovës ka marrë vendime për ndeshjen e

shumëpërfolur në mes të Gjiolanit dhe Prishtinës. Klubi i Prishtinës, për sjellje dhe veprime të gabuara të stafit të klubit, pas përfundimit të

ndeshjes ndaj Gjilanit, për dëmtimin e inventarit në zhveshtoret në të cilat ishin të vendosur mysafrët, dënohet me 1500 euro. Trajneri Armend

Dallku, për manifestim të sjelljeve josportive (tentimsulmi në gjyqtarin kryesor), pas përfundimit të ndeshjes dënohet me 500 euro. Portieri Visar Bekaj

për kartonin e kuq është dënuar me dy ndeshje. Ai pritet të mungojë edhe në takimin e radhës që Prishtina e zhvillon si mysafire ndaj Ballkanit.

## Rashica refuzon Liverpoolin dhe Milanin për Leipzigun

BREMEN, 16 QERSHOR - Menaxheri i futbollistikit të njohur të Kosovës, Milot Rashica dhe ish-futbollisti i shqipërisë, Altin Lala, pranoi se RB Leipzig i përshtatet më

së miri stilit të lojës së 24-vjeçarit. Për "Deuchstube", Lala shtoi se RB Leipzig është një klub i aftë t'i bëjë lojtaret më të zotë. Sipas "Sport Bild", Rashica ka refuzuar Milanin dhe

Liverpoolin dhe dëshiron të luajë për skuadrën e njohur gjermane. "RB Leipzig është një klub interesant. Trajneri dhe stilist i tyre i lojës i përshtaten shumë mirë Milotit. Përveç

kësaj, ata janë një klub që i përmirësojnë futbollistik", u shpreh Lala. Werder Bremen pranon ta shesë mesfushorin me tipare sulmuese për jo më pak se 20 milionë euro.



## Ambasadori Heldt: FFK-ja duhet të punojë për avancimin e futbollit



PRISHTINË, 16 KORRIK (ER) - Ambasadori gjerman në Kosovë, Christian Heldt, me rastin e përfundimit të mandatit të tij në vendin tonë, ka pritur sot kryetarin e Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi dhe sekretarin e Përgjithshëm, Eroll Salihu. Sipas njoftimit të FFK-së, Heldt e ka përgëzuar Ademin për punën e mirë që ka bërë në krye të Federatës së Futbollit, teksha ka theksuar se Përfaqësuesja e Kosovës me paraqitjet e treguara e ka bërë atë fans të saj. "Ambasadori gjerman inkurajoi kryetarin

Ademi dhe sekretarin e Përgjithshëm Salihu që ta vazhdojnë punën e mirë dhe avancimin e futbollit në Kosovë. Ndërkohë, Ademi e falënderoi ambasadorin Heldt për përkrahje dhe përqendrimin e tij të drejtë dhe bashkëpunues, ashtu siç janë edhe marrëdhëniet me DFB-në, ku Rainer Milkoreit është edhe ambasador nderi i Kosovës dhe përgjegjës për Kosovën në DFB", thuhet në njoftimin e FFK-së. Kryetari Ademi e falënderoi edhe shtetin gjerman dhe DFB-në që mundësojnë funksionimin e Federatës së Futbollit Shqiptar në Gjermani dhe klubave shqiptare atje, teksha përmendi edhe komunitetin tonë atje dhe talentet e shumta dhe familjet e tyre që bëjnë gjithçka për ta lartësuar emrin e Kosovës. Ademi bëri me dije, po ashtu, se FFK-ja ka nënshkruar kontratë bashkëpunimi edhe me Unionin e Biznesit Shqiptar në Gjermani, derisa një mbështetje të vazhdueshme e ka pasur nga përfaqësuesit e FFK-së, Ruzhdi Statovci me FFShGj, vëllezërit Shoshi dhe Fekmi Kongjeli.

## Federeri: Wimbledoni më mungon shumë, rikthehem vitin tjetër

CYRIH, 16 KORRIK - Roger Federeri pranon se të mos luajë në grand slam të Wimbledonit këtë vit e ka mërzitur shumë. Ky është turneu i tij i preferuar, aty ku zvicerani ka triumfuar tetë herë në karrierën e tij, ndërkohë që në total ka fituar 20 grand slam. Gjithsesi, koronavirusi bëri që organizatorët e turneut londinez ta anulojnë atë, ndërsa vetë Rogeri të "dorëzohet", duke zhvilluar një operacion të dytë. Numri katër në botë pritet të rikthehet në fushë në janar të 2021-shit. "E pranoj që Wimbledoni më mungon shumë. Për këtë arsy po punoj fort, që të jem aty vitin tjetër. Unë po rikuperoj dhe shpresoj në janar të jem gati. Në Wimbledon kam



shumë kujtime dhe dua t'i përjetoj sërisht vitin tjetër", ka thënë tenisti zviceran. "Kam ende një rrugëtim të gjatë deri në rikthimin në fushë, por gjërat po ecin mirë. Nuk dua të

nxitohem, kam kohë, ndërkohë që deri në janar situata mund të ndryshojë sërisht. Ndaj dua të jem gati për vitin tjetër", ka deklaruar Federeri.

## SHKURT

### Hulk planifikon të rikthehet në Brazil

Pas pesë vjetësh në futbollin kinez, sulmuesi 33-vjeçar Hulk po përgatit largimin nga Shanghai Sipg. Futbollisti brazilian i ka idetë e qarta për të ardhmen dhe ua ka bërë të qartë drejtuesve që nuk do ta rinovojë kontratën që skadon në dhjetor të këtij viti. Kampionati kinez pritet të rinashtet më 25 korrik dhe Hulk do të luajë në muajt e fundit me fanellën e ekipe të Shanghait. Sipas mediave braziliiane, lojtari synon të rikthehet në vendlindje, ku ka disa oferta, por bisedimet konkrete kanë qenë me skuadrën e Sao Paolos.

### Sanchezi kushton 20 milionë euro

Manchester Unitedi e ka informuar Interin se do ta mendojë shitjen e Alexis Sanchezit vetëm për një shumë reth 20 milionë euro. Sanchezi ka filluar ta gjejë formën e vjetër në Inter, pasi e ka shënuar një gol dhe i ka dhuruar pesë asistime në shtatë paraqitje pas pandemisë. Sipas "Gazzetta dello Sport", 31-vjeçari ka bërë mjaftueshmë për ta fituar qëndrimin e përherëshmë në Inter. Megjithatë, e përditshmja italiane paralajmëron se Unitedi nuk do të pranojë ta lejojë kilianin në huazim edhe për një vjet tjetër, sepse dëshiron ta shesë përfundimisht. Çmimi që e kërkon gjiganti anglez është 20 milionë euro.

### Porto fiton titullin e 29-të në Portugali

Porto ka siguruar titullin e 29-të në histori të klubit, duke e fituar betejën e gjatë kundër Benficas. Ish-mbrojtësi i Real Madrid, Pepe, ka festuar titullin e dytë në tre vjetët e fundit në Portugali, falë fitores 2:0 ndaj Sporting Lisbonës. Danilo Pereira dhe Moussa Marega shënuan përfitoren e Portos në këtë përballje. "Ky ekip duhet të përgëzohet për atë që ka bërë, dhe jo vetëm në këtë ndeshje", ka deklaruar Pepe. "Sportingu ka qenë në formë shumë të mirë, por ne dinim si t'i eliminonim pikat e tij të forta. Ky është fundi i një pune të madhe", ka shtuar ai.

### Torresi zëvendëson Sanen në City

Ferran Torres është një nga lojtarët më të rëndësishëm të Valencias që do të largohen këtë verë nga skuadra. Drejtuesit parashikojnë një revolucion me shumë prurje dhe largime të mëdha. Pep Guardiola e shikon si zëvendësuesin e Sanes, të larguar drejt Bayernit dhe ka marrë miratimin e lojtarit për ta transferuar në Premier Ligë. 20-vjeçari nuk ka pranuar ta rinovojë kontratën që skadon vitin tjetër ndaj dhe Valencias është e detyruar ta shesë 30-40 milionë euro pavarësisht klauzolës prej 100 milionë eurosh të lojtarit.

### Fury, Wilderit: Po bëhem gati për ty 'lëpirës'

Kampioni i botës në peshën e rëndë, boksieri britanik Tyson Fury, ka deklaruar se i është rikthyer palestrës me një qëllim të vetëm: ta mposhtë sërisht amerikanin Deontay Wilder. Dy bokserët pritet të zhvillojnë në dhjetor sfidën e tretë mes tyre (sfida e parë u mbyll barazim dhe në të dytën triumfoi Fury). Edhe Wilderi është duke u stërvitur dhe rikuperuar pas operacionit, por kohët e fundit ka vendosur të mos japë intervista. Duket se ai ka nevojë për t'u motivuar para sfidës së tretë me Fury. Wilderi mori një goditje të rëndë në duelin e fundit me Fury, kur pësoi humbjen e parë në karrierën e tij. "Bronze Bomber, po vij për ty 'lëpirës', ka qenë komenti i Furyt në rrjetet sociale, duke iu drejtuar boksierit amerikan me nofkën e tij. Gjasat janë që kjo përballje e tretë të zhvillohet më 19 dhjetor, por ende nuk është konfirmuar vendi i saktë. Situata e krijuar nga koronavirusi ka lënë ende mjaft dilemë për këtë përballje.



					Autor: GAZMEND MORINA	BIMË BARISHTORE QË KA VLERA TË MËDHA USHQIMORE	QULL I TRAS- HË ME MIELL MISRI	QYTET NË ITALI	MJET I MADH LUNDRIMI (shq.)	PJESA E ERRËT E DITËS	ZANORE	PËR MË TEPËR, MADJE	EPOKA ERE	KRYEQYTTI EVROPIAN I MODËS	QË U PËRKET PARAARDHË- SVE TONA	GAZETË QË BOTOHET NË SHQIPERI
ISH AKTORI PALLASKA	KËNGËTARJA ANGLEZE NË FOTO	DËMTIM I NJË MAKINE GJATË KOHËS SË PUNËS	SKENARISTI JETON .....	JO I VJETËR	EPOKA ERE	KANDËRR E VOGËL ME NGJYRË TË ZEZË "MOLDE"										ESTONIA ZANORE
KLUB FUTBOLLI ANGLEZ						AKTORI ADRIAN FLETË LETRE PËR DUHAN										
PAJTUESHM- ÉRIA (krah.) BUKURIA, HIJESHLIA (krah.)							NOTE MUZIKORE EMËR MASHKULLI TURK									ISTRES SHKRIMTARI .... SHEHU (shq.)
KLUB I YNI FUTBOLLI						SERË "INDONEZIA"										PERSIA E SOTME
BASHKËT.		KRYEQYTTI I NJË SHTETI EVRO-AZIATIK NJE LLOJ SHPAT JO SHUMË E MADHE														
"O" para dy "J"						SUPER MODELJA KANADEZE JESSICA	TËRËSI E MIT- EVE TË NJË POPULLI ISH PORTIERI GJERMAN OLIVER ...									
LLUKA ANTONINI						NUK KA (bised.) I FILLUAR			ZANORE	BARAZIM NË SHAH DOLLAP PËR TË MBAUTUR ZOGJ (shq.)					ZANORE ISH TRAJNERI YNË I BOKSIT LAH .....	
EPOKA ERE	SHUMË I MADH DHE I FUQISHËM ARTI I VALLE- VE ME FIGURA (pashq.)									FUTBOLLISTI KALOU (CHELSEA) QË LIDHET ME DITËN	SHTET NË AZI (pashq.)	MIMOZA MUSTAFA QYTET NË KOSOVË				LLOJ VEGLE MUZIKORE (sh.shq.)
PEMË E VEN- DEVE TROP- KALE							AFËRDITA DEMAKU KËNGËTARJA ... KOÇI			SHEGË FUTBOLLISTI .... TOURE (MANCHESTER CITY)					REPERJA JONË ... VLORA NATIONAL UNION TEACHERS	
POETI VINCA						FUTBOLLISTI SHQIPtar OSMANI OSMAN (perkdh.)				AGJËRIMI (krah.) RINOR (perkdh.)						
"... VEGAS"				XEHETAR KALJARI, ANKONA						PIRAT NOTE MUZIKORE						
E KËPUTA (krah.)						VEÇIM NGA RRETHI KU JETOJMË ZANORE					KËNGËTARJA ALTUNA SEJDIU BASHKËT.					
KRYEQYTTI SHQIPtar						SATIRIK					TËRËSI E VEPRIMEVE TË NJË KULTI FETAR					



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës së Jugut  
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South



## FTESË PUBLIKE PËR PJESËMARRJE NË SHQYRTIM PUBLIK NË PROCESIN E PËRGATITJES SË PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL TË MITROVICËS SË JUGUT

Për: Qytetarët e Qytetit të Mitrovicës së Jugut, Personave Juridik, Shoqatave dhe Grupet tjera  
Lokacioni: Qendra e Kulturës "Rexhep Mitrovica" në Mitrovicë  
Data: 23.07.2020  
Koha: 13:30

Të nderuar qytetarë të Qytetit të Mitrovicës së Jugut

Drejtoria e Planifikimit dhe Urbanizmit (DPU) në bashkëpunim me kompaninë "INSI" nga Prishtina, ka kënaqësinë t'ju ftojë të jeni pjesë e Shqyrtimit Publik për draft Planin Zhvillimor Komunal te Mitrovicës së Jugut.

DPU kérkon pjesëmarrjen tuaj aktive dhe njofimin tuaj mbi përpjekjet e Komunës për të përgatitur PZHK-në për Mitrovicën e Jugut, dhe gjatë këtij procesi ne mirëpresim nga ju që të paraqitni propozimet, vërejtjet dhe sugjerimet për hartimin e këtij dokumenti shumë të rëndësishëm.

DPU është e përkushtuar të bashkëpunoi ngushtë me të gjitha palët e interesuara që janë të gatshme për të kontribuar për përgatitjen e një Plani Zhvillimor Komunal të qëndrueshëm për Komunën tonë dhe pronat tuaja, për 8(tetë) vitet e ardhshme 2020-2028.

Pjesëmarrja juaj do të mundësoj një planifikim të mirëfilitë duke ndikuar dhe kontribuar drejtpërsëdrejtë në përmirësimin e jetës në vendbanimin tuaj.

Pjesëmarrësit e interesuar, janë të obliguar që, me rastin e ardhjes t'i respektojnë në mënyrë strikte masat e caktuara nga IKSHP dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, siç janë; të jenë të pajisur me maska mbrojtëse, si dhe t'a respektojnë mbajtjen e distancës së paraparë për siguri të seclit.

Me respekt.



## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregatitje për intervistë



[facebook](#)

[www.facebook.com/gjejpuneshpjeite](http://www.facebook.com/gjejpuneshpjeite)

RESTAURANT  
**SWISS**  
TAVERNA

Tel: +377 45 400 156     +386 49 848 553

PRISHTINË

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Mehreme (Shaqiri) Hasani e lindur me 10.09.1970 me nr. Personal 1005247434 ne Fshatin Tushilë komuna Skenderaj e shpall te humbur Certifikatën e notave te shkollës Fillore "Iliria" te cilën e ka kryer ne Tushilë ne vitin 1980-81.
- Jap banesë me qira afër 60 m2, katër III-Lagjë Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplekt, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të komplektuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.
- Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muhammed Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, katër dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muhammed Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përbull "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, katër dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.
- Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpianë katë i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana katë i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- Lëshoj lokalini më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", katër tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- Lëshoj banesë me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesë me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesë me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplekt, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër të prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)
- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër t'ë tel: 049-440-466.
- Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplekt. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në t'ë njëtin numër në viber.
- Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, katë i I-rë, ka 3 dhoma, banjo, ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet. Për info: 045/699-221.
- Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qerimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.
- Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783
- Lëshoj banesë me qira në Ulpianë, tek Fontana në: E 30-3A, nr.27, katë -IV-. Çmimi sipas marrëveshjes në info: 044-132-368.
- Kërkoj dy bashkëbanuese, mundësishët të cilat janë duke punuar. Banesa gjendet në qendër të qytetit në Prishtinë përbull Prokurorisë së shtetit (ish-ndërtesa e OSBE-së), ose ish-ndërtesa e Bankës së Lubjanës), rruga "Hajdar Dushi", afër shtabit kryesor të Policisë së Kosovës. Banesën mund ta shiheni çdo ditë. Numri i telefonit: 049/402-518.
- Shesim banesën dy dhomëshe në Ulpiana D8 h3 Nr 15 katë 3 ndërtim i vjetër, e rinovuar komplekt, me nxemje të qytetit, çmimi 77 000€. Informatat tel:049/400-958 dhe 044/627-387